



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TÜRKIYE

Udhëzimet e DG NEAR
për Mbështetjen nga BE të
Shoqërisë Civile në
Rajonin e Zgjerimit
2021–2027

Raporti i Vlerësimit 2023

ANEKSI 3
**ANALIZA PËR
KOSOVËN**



Funded by
the European Union



Ky studim është realizuar nga një ekip kërkuesish nën mbikqyrjen e projektit EU TACSO 3.

Ekspertja drejtuese dhe autorja kryesore: Snježana Bokulić

Expertja e analizës së të dhënave dhe anketimit: Dr. Blerina Metanj Subashi

Autorët për analizën për vendet përkatëse:

Natasha Mazari – Shqipëri

Kanita Kulić – Bosnie dhe Herzegovinë

Sara Salihu – Kosovë

Aleksandra Gligorović – Mali i Zi

Marija Armenski – Maqedonia e Veriut

Jelena Pajović van Reenen – Serbi

Özge Konuralp – Turqi

Drejtuesi i Ekipit EU TACSO 3: Richard Allen

Këshilltarë Ligjor:

Dr. Ersida Teliti - Shqipëri

Selim Kulić – Bosnie dhe Herzegovinë

Miljan Vlaović – Mali i Zi

Maja Atanasova – Maqedonia e Veriut

Dr. Robert Sepi – Serbi

Assoc. Prof. Dr. Ulaş Karan – Turqi

Redaktor i Gjuhës: prof. Jonathan Boulting M.A. (Eng. Lit. Trnwlty, Cantab)

Dizenjimi Grafik: Bojan Ivanović, Brigada Design

Beograd, Serbi, Qershor 2024

<https://tacso.eu>

Hyrje

Analiza për Kosovën është një nga Aneksat e Udhëzimeve të DG NEAR për Mbështetjen nga BE të Shoqërisë Civile 2021–2027: Raporti i Vlerësimit 2023.

Udhëzimet paraqesin rezultatet që mbështetja e BE-së për shoqërinë civile synon përgjatë kësaj periudhe 7-vjeçare. Ky vlerësim ofron evidencë mbi situatën krahasuar me treguesit e Udhëzimeve për 2023, dhe një krahasim me vitin e analizës bazë 2021.

Ky aneks jep një përmbledhje të të dhënave për vlerësimin e situatës në Kosovë¹ kundrejt secilit prej 59 treguesve të përfshirë në Udhëzimet. Ky aneks duhet të lexohet së bashku me raportin kryesor, i cili mund të gjendet në faqen e internetit tacso.eu.

Metodologjia

Analiza e paraqitur në raportin kryesor dhe anekset për përfituesit IPA është bazuar në të dhënat e mbledhura nga burime parësore dhe dytësore. Kërkimi parësor përfshin anketat me OSHC-të dhe zyrtarët publik, si dhe analizën ligjore të ligjeve të rëndësishme. Burimet dytësore si raportet e prodhuara nga OSHC-të, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, qeveria, dhe burime të tjera të cilat u rishikuan për të grumbulluar informacionin dhe të dhëna e duhura. Grumbullimi dhe analiza e të dhënave i referohet kryesisht vitit 2023, krahasuar me bazën e nisjes së vitit 2021.

Anketa me zyrtarët publik është realizuar nga 27 shkurt deri me 13 mars 2024. Anketa synoi të grumbullojë për disa nga treguesit më të rëndësishëm, perpektivën e zyrtarëve të përzgjedhur publik, të cilët në punën e tyre angazhohen më së shumti me OSHC-të. Anketa konsistoi kryesisht në pyetje të mbyllura dhe ishte anonime. Në Kosovë u morën 13 përgjigje nga zyrtarët publik.

Vlerësimi i kapacitetit dhe qëndrueshmërisë së OSHC-ve është bazuar mbi një anketë të OSHC-ve, e cila është administruar nga 31 Janar – 19 Shkurt 2024. Anketa ishte e hapur për çdo OSHC të interesuar. Për të bërë të mundur përfshirjen e një game të gjërë të OSHC-ve në anketë, ajo u shpërnda nëpërmjet kanaleve të ndryshme, me mbështetjen e OSHC-ve, rrjeteve të OSHC-ve, Qendrës Kombëtare Burimore, agjensive të OKB, Delegacionit të BE-së, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve publike. Gjatë fazës paraprake, për tu siguruar që përgjigjet ishin ato që duhen, u filtruan të anketuarit që u përgjigjën se nuk i përkasin grupit të synuar. Bazuar në numrin e përgjigjeve të vlefshme, kufiri i gabimit ishte nën 10%. Ky kufi i gabimit është llogaritur statistikisht duke përdorur numrin e OSHC-ve të listuara në Regjistrin Qëndror zyrtar të Kosovës për të përcaktuar madhësinë e grupit.

Anketa e OSHC-ve është qarkulluar gjërisht dhe mori njëqind e pesë (105) përgjigje të vlefshme nga OSHC-të e Kosovës në total.

Pothuaj gjysma e përgjigjeve, 46%, ishin nga drejtorët ekzekutivë të organizatave, 23% ishin nga menaxherë dhe 14% nga menaxherë të lartë.

¹ Ky përcaktim është pa paragjykim lidhur me pozicionin ose statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e ICJ mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës

60% e OSHC-ve pjesëmarrëse punojnë në nivel lokal, 50% e tyre në kryeqytet. 51% e të anketuarve u identifikuan si gra, 47% si burra, dhe vetëm 1% u identifikuan si jo-binary. Rreth 3/5 e të anketuarve, 61%, ishin 31 vjeç ose më shumë; 28% ishin më shumë se 51 vjeç. Çereku i të anketuarve, 30%, u identifikuan si pjesëtarë të komuniteteve, monitoriteteve, ose grupeve të marginalizuar. Nga këta, 3% u identifikuan si persona me aftësi të kufizuara, 4% si pjesëtarë të komuniteteve Roma, Ashkali ose Egjiptian, por asnjëri si pjesëtar i komunitetit LGBTQ+.

82% e OSHC-ve pjesëmarrëse janë krijuar gjatë dy dekadave të fundit dhe afërsisht gjysma e tyre, 40%, midis viteve 2011–2021. Vetëm 4% e OSHC-ve pjesëmarrëse janë krijuar në 1990 ose më heret. Virtualisht, të gjithë përgjigjet, 98%, erdhën nga organizata të regjistruara zyrtarisht. Pothuaj gjysma e organizatave pjesëmarrëse, 49%, ishin të regjistruara si shoqata të qytetarëve; 15% ishin fondacione.

Pjesa më e madhe e OSHC-ve pjesëmarrëse në anketë, 28%, deklaruan se punonin në sektorin e edukimit, kërkimit dhe novacionit, 24% në sektorin e rinisë, pasuar nga 23% në sektorin e përfshirjes sociale dhe 21% në zhvillimin social-ekonomik; 19% punojnë në të drejtat e minoriteteve dhe mos-diskriminimin. 13% punojnë në të drejtat e njeriut dhe 13% në fushën e mjedisit dhe klimës.

Më shumë se gjysma e OSHC-ve pjesëmarrëse, 64%, ishin organizata të vogla me 1–10 staf të përhershëm me kohë të plotë, të pjesshme dhe vullnetarë në kohën e zhvillimit të Anketës. Vetëm 6% e OSHC-ve pjesëmarrëse kishin 51 ose më shumë staf ose vullnetarë.

Pothuaj gjysma e OSHC-ve pjesëmarrëse, 49%, kishin një qarkullim vjetor deri në € 25,000. 20% e të anketuarve thanë se qarkullimi i tyre vjetor ishte midis € 100,001 dhe € 500,000, ndërsa 9% thanë se qarkullimi i tyre vjetor kalonte € 500,000.

Vlerësimi kundrejt treguesve

Të dhënat e mbledhura u përdorën për zhvillimin e analizës së situatës në 2023 kundrejt seicilit tregues dhe vlerat krahasuese kundrejt situatës bazë të vitit 2021.

Të dhënat e mbledhura u përdorën për analizën e situatës në 2023 në Kosovë kundrejt treguesve që po vlerësohen.² Treguesit u rishikuan dhe vlerësuan sipas së njejtës metodë të ndjekur në vlerësimin e situatës bazë. Për të siguruar më shumë qartësi dhe saktësi në vlerësim, metodologjia për tre tregues është plotësuar me analizë shtesë.² Ndryshimet për të thjeshtuar anketën e OSHC-ve ndikuan tek tetë tregues për të cilët situata bazë e vitit 2021 u ri-llogarit.³

Për treguesit që kanë një vlerësim normativ, si përputhja me legjislacionin ose standardet, sistemi i mëposhtëm i dritave të semaforit u përdor për të ofruar një guidë të shpejtë vizuale:

5 – plotëson të gjithë standardet

4 – plotëson shumicën e standardeve

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

2 – plotëson standardet minimalisht

1 – nuk i plotëson standardet

2 Treguesit e mëposhtëm nuk janë rishikuar për 2023: 1.7.b; 1.10.e; 2.1.b; 2.1.c; 3.2.b; 3.8.c. Këto tregues janë përjashtuar nga rishikimi sepse mbedhja e të dhënave për ti vlerësuar ato nuk ishte e mundur ose sepse gjuha e treguesve ishte pamjaftueshmërisht specifike që të mundësonte mbledhjen e të dhënave dhe analizën konsistente.

2 Vlerësimi i treguesve të mëposhtëm është plotësuar me analizë shtesë: 1.2.a; 1.3.b; 1.6.b.

3 Baza e nisjes për treguesit e mëposhtëm është ri-llogaritur: 1.1.a; 1.4.a; 1.5.b; 1.7.d; 1.9.a; 3.3.a; 3.4.a.

Sistemi i dritave të semaforit u aplikua për ata tregues ku u gjykua se vlerësimi kishte kuptim. Ai u bazua ose në të dhënat e grumbulluara nëpërmjet Anketës së OSHC-ve ose analizës së detajuar kundrejt standardeve të ligjeve të aplikueshme, politikave dhe procedurave. Shpjegimi i vlerësimit gjendet në raportet përkatëse të Përfituesve IPA dhe analizës në Aneksat 1-7.

Treguesit e tjerë japin një pamje të trendeve vit-pas-viti duke u nisur nga situata bazë e nisjes e vendosur në 2021.

Raporti përmban vlerësimet dhe nivelin e zbatimit të treguesve individualë bazuar në strukturën e objektivave specifike nën secilën prej tre fushave.



Objektivi Specifik 1

Ka një mjedis mundësues për shoqërinë civile për të realizuar aktivitetet e saj.

OS 1.1. Të gjithë individët dhe subjektet juridike në rajonin e zgjerimit mund të krijojnë, t'i bashkohen dhe të marrin pjesë në organizatat jo-formale dhe/ose të regjistruara, mund të mblihen dhe të shprehen lirisht.

Treguesi 1.1.a: Masa në të cilën legjislacioni relevant kombëtar mundëson që:

- Shoqatat mund të krijohen ose regjistrohen pa asnjë lloj diskriminimi;
- Nuk ka kufizime të paligjshme për gamën e aktiviteteve ose arritjen e objektivave të tyre;
- Shpërndarja e tyre mund të ndodhë vetëm pas një vendimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme;
- Nuk ka kufizime të paligjshme për lirinë e tubimit paqësor;
- Liria e shprehjes ushtrohet nga të gjithë dhe nuk ka kufizime të paligjshme.

2021:

4 – plotëson shumicën e standardeve

2023:

4 – plotëson shumicën e standardeve

Në përgjithësi, ligji mbi lirinë e tubimit paqësor është në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Adoptimi i ligjit të ri mbi tubimet publike ka qenë konsideruar si një përparim pozitiv në legjislacion krahasuar me vlerësimin e vitit 2021.

Deri në fund të 2023, nuk ka pasur ndryshime në legjislacionin e vendit lidhur me lirinë e shprehjes. Në përgjithësi, Ligji mbi Lirinë e Asocimit dhe aktet nënligjore të lidhura me të janë në përputhje me standardet e legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut³. Sidoqoftë, midis sfidave të identifikuar për zbatimin, si sulmet në rritje kundër gazetarëve, veçanërisht gjatë protestave/barrikadave në Veriun e Kosovës me shumicë serbe, theksuan nevojën për pluralizimin dhe sigurinë e mediave. Zyra e Prokurorisë së Kosovës nuk ka ngritur ndonjë akuzë në këto raste⁴.

Sidoqoftë, që nga vlerësimi i vitit 2021, legjislacioni i ri është adoptuar. Në nëntor 2022, Qeveria e Kosovës adoptoi një Udhëzim Administrativ të ri⁵ lidhur me regjistrimin, operimin dhe çregjistrimin e OJQ-ve, në përputhje me Ligjin Për Lirinë e Asocimit⁶ në OJQ-të. Ky udhëzim i ri përqëndrohet në shpërndarjen përherëshme dhe çregjistrimin e OJQ-ve, duke përcaktuar hapat për shpërndarjen vullnetare dhe jo-vullnetare dhe një proces të strukturuar për burimin ligjor, përfshirë të drejtën për të sfiduar vendimet mbi çregjistrimin. Një ndryshim tjetër është shtyrja e afatit për regjistrimin e OJQ-ve nga 30 në 45 ditë, që në praktikë mund të përfaqësojë një sfidë për OSHC-të. Për më tepër, periudha më e gjatë e regjistrimit është disproporcionalisht më e gjatë krahasuar me afatet e caktuara për regjistrimin e bizneseve.

3 Vendimi i Gjykatës Tregëtare në Gusht 2023 që ndalon revokimin e licencës së biznesit të Klan Kosova velrësoi pavarësinë gjyqësore dhe mbrojtjen e lirisë së shtypit kundrejt ndërhyrjes qeveritare. Ky vendim, pas përpjekjes së Minsitrisë së Industrisë së Kosovës për të pezulluar licensën e kanalit TV, u përshendet nga organizatat globale të lirisë së medias, duke theksuar rolin e gjyqësorit në mbrojtjen e të drejtave themelore.

4 BCSDN Monitoring Matrix Periodical Updates, në: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://balkancsd.net/novo/wp-content/uploads/2024/04/MM-PERIODICAL-UPDATE-April-2024-Revised-1.pdf>

5 Udhëzim Administrativ (Grk) - No. 12/2022 Për Regjistrimin, Operimin dhe Çregjistrimin e OJQ-ve, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66914>

6 Ligjin no. 06/L-43 Për Lirinë e Asocimit në OJQ-të, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>.

Kosova adoptoi një ligj të ri Për Tubimet Publike⁷ në shkurt 2022, i cili rishikon disa dispozita të ligjit të vitit 2009. Ai shtrin të drejtën për organizim ose pjesëmarrje në tubimet publike nga “çdo qytetar” në “çdo person” dhe ripërcakton tubimet publike si përfshirje e «dy ose më shumë individë,» duke rritur qartësinë dhe mbrojtjen për grupet më të vogla. Ndryshe nga ligji i vitit 2009, legjislati i ri heq nenin që lejon ndalimin e tubimeve të panjoftuara. Ai zëvendëson «roje në detyrë» me “stjuard,» që ka role të kufizuara, në rradhë të parë për të identifikuar shkelësit e rregullave. Koha e njoftimit tek policia është rritur nga 72 në 96 orë për ngjarjet standard dhe nga 3 në 6 orë për grumbullimet urgjente. Një mekanizëm i ri koordinues lejon policinë të vendosë kufizime deri në 48 orë para ngjarjes. Autoriteti i policisë për të ndaluar ngjarjet është përcaktuar qartë, duke kërkuar njoftimin jo më pak se 5 ditë përpara⁸.

Demonstratat publike tani quhen «ngjarje publike,» me kërkesa të detajuara për njoftimin, përfshirë detaje të organizatorëve dhe masave të sigurisë. Sidoqoftë, zgjatja e periudhës së njoftimit mund të mos përputhet plotësisht me praktikën më të mirë që avokojnë për fleksibilitet, burokraci minimale dhe lehtësim të grumbullimeve spontane⁹. Rritja e periudhës së njoftimit mund të shihet si një kufizim potencial i mundësisë për të organizuar sic duhet grumbullimet paqësore, sidomos në përgjigje të ngjarjeve urgjente ose të paparashikuara. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut theksojnë rëndësinë e lehtësimit dhe mbrojtjes së tubimeve, përfshirë edhe ato spontane, nga zbatuesit e ligjit, në vend të shpërndarjes së tyre bazuar vetëm në mungesën e njoftimit paraprak. Legjislati nuk adreson në mënyrë eksplicite se si zbatuesit e ligjit duhet të menaxhojnë tubimet që nuk plotësojnë kërkesat e reja lidhur me njoftimin, duke lënë një boshllëk lidhur me përputhjen midis veprimeve të policisë dhe standardeve ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtës për tubim paqësor.

7 Ligji No. 08/L-166 Për Tubimet Publike: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=70935>.

8 Policia, bazuar në vendim me shkrim, jo më vonë se pesë ditë para ngjarjes publike mund të ndalojë atë bazuar në një nga arsyet e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 10 të këtij ligji, me një kohë prej 48-orësh për organizatorët për të apeluar në Komisionin e Ankesave. Organizatorët kanë të drejtën e apelimit të mëtejshëm në Gjykatë.

9 Studimi i pavarur i kontraktuar nga TACSO 3 për analizën ligjore, doli me konkluzionin se legjislati i ri ka adoptuar një sistem lajmërimi lidhur me një qasje të bazuar në lejen në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sidoqoftë, sfidat e identikuara në zbatim përfshijnë zgjatjen e periudhës së lajmërimit nga 72 në 96 orë për tubimet publike dhe nga 3 në 6 orë për tubimet urgjente, e cila mund të mos jetë plotësisht në përputhje me parimet e fleksibilitetit dhe burokracisë minimale. Ndërsa ndryshimet synojnë të sigurojnë njoftimin e duhur, ato mundet që potencialisht të pengojnë organizimin në kohë të tubimeve paqësore, sidomos në përgjigje të situatave urgjente. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut theksojnë rolin e zbatuesve të ligjit në lehtësimin dhe mbrojtjen e tubimeve, por legjislati nuk ka akoma udhëzime të qarta për menaxhimin e tubimeve që nuk plotësojnë kërkesat e reja të njoftimit, duke ngritur shqetësim rreth përputhjes me këto standarde.

OS 1.2. Autoritetet publike mbrojnë OSHC-të nga ndërhyrjet dhe sulmet dhe repektojnë të drejtën e tyre të privatësisë.

Treguesi 1.2.a: Sa OSHC-të kanë mundësinë e një ndërhyrje efektive për të sfiduar ose kërkuar rishikimin e vendimeve që prekin ushtrimin e të drejtave të tyre.

2021:

3 – moderately meets standards

2023:

4 – plotëson shumicën e standardeve

Në dhjetor 2023, **Ligji Për Lirinë e Asocimit në OJQ-të u amendua me Ligjin no. 08/L-244**¹⁰. Amendamenti përfshiu ndryshimin e nenit 43 të ligjit fillestar që rregullon të drejtën për trajtim ligjor, që ishte identifikuar si një sfidë në vlerësimin e vitit 2021. Neni i ri¹¹ përcakton procedurën e apelimit nga OSHC-të, duke përcaktuar në mënyrë eksplicite një trupe rishikimi, Komisionin e Apelit¹², i caktuar nga Ministri i Administratës Publike për të rishikuar apelimet, çfarë mungonte në nenin e mëparshëm. Sidoqoftë, lidhur me aktin nën-ligjor (që rregullon metodën e zgjedhjes, mandatet, dhe përbërjen e Komisionit të Apelit) referuar në paragrafin 3 të nenit të ri 43, ne nuk kishim mundësi të gjejmë ndonjë përditësim që nga 2012.¹³ Ndikimi i ndryshimeve të tilla ngelet për tu parë, ndonëse në teori ato mund të shihen si pozitive, sepse kërkesa të tilla mund të konsiderohen më liberale për OSHC-të.

Lidhur me trajtimin ligjor të OSHC-ve përtej regjistrimit dhe çregjistrimit, nuk kanë ndodhur ndryshime që nga raporti i fundit në 2021. Sidoqoftë, **Ligji Për Procedurat e Përgjithshme Administrative (05/L-031)**¹⁴ dhe Ligji i ri **Për Mosmarrveshjet/Konfliktet Administrative (03/L-202)**¹⁵ detajojnë më tej të drejtën për trajtim ligjor në procedimet administrative dhe gjyqësore.

Bazuar në Anketën e OSHC-ve të 2023, 78% e të anketuarve thanë se ata nuk kanë pasur rast ku autoritetet qeveritare kanë marrë vendime mbi organizatën e tyre që do të ndikonin negativisht punën e tyre. Sidoqoftë, **6% e të anketuarve thanë se në 2023 autoritetet qeveritare morën vendime mbi organizatën e tyre të cilat ndikuan negativisht në aftësinë e tyre për të ushtruar të drejtat**, dhe deri në fund të vitit 2023, asnjë nga këta OSHC nuk mundi të sfidojë efektivisht këto vendime nëpërmjet kanaleve zyrtare, ligjore, gjyqësore, ose administrative.

10 Ligji No. 08/L-244 Për Amendimin dhe Plotësimin e Ligjit No. 06/L-043 Për Lirinë e Asocimit në OJQ-të, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85110>

11 Neni 43:

E drejta e apelit.

1. Kundër çdo vendimi final bazuar në ligjet bazë dhe në këtë ligj, apelimi lejohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës Për Procedurat e Përgjithshme Administrative.

2. Organi më i lartë që rishikon apelimet nën këtë nen është Komisioni i Apelit, i caktuar me vendim të Ministrit të Administratës Publike, i përbërë nga tre (3) anëtarë, njëri nga të cilët duhet të jetë një përfaqësues nga sektori i OJQ-ve.

3. Metoda e zgjedhjes, mandate dhe përbërja e Komisionit të Apelit duhet të përcaktohet nga një akt nën-ligjor i Ministrit të Administratës Publike.

12 Komisioni duhet të përfshijë tre anëtarë, njëri nga të cilët duhet të jetë nga sektori i OJQ-ve, për të siguruar një përfaqësim më të gjërë. Përveç kësaj, neni i ri mandaton një akt nën-ligjor nga Ministri për përcaktimin e zgjedhjes së Komisionit, mandatit dhe përbërjes, detaje që nuk ishin në ligjin e mëparshëm. Të dy nenet lejojnë apelimin kundër vendimeve bazuar në Ligjin Për Procedurat e Përgjithshme Administrative, por neni i ri thekson proceset e strukturuar të apelit dhe përfaqësimit.

13 Rregullore no. 02/2012 Për Krijimin dhe Operimin e Komisionit të Rishikimit të Ankesave nga OJQ-të, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10194>

14 Ligji Për Procedurat e Përgjithshme Administrative (05/L-031), në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

15 Ligji Për Mosmarrveshjet/Konfliktet Administrative (03/L-202), në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2707> (në fuqi nga 31.12.2023).

Treguesi 1.2.b: Masa në të cilën OSHC-të janë të mbrojtura me ligj kundrejt kërcënimeve, sulmeve, ngacmimeve ligjore dhe trajtimit diskriminues, në veçanti:

- Kërcënimet përfshirë intimidimin, ngacmimin, shpifjen, si dhe gjuhën e urrejtjes, fizikisht dhe online;
- Sulmet përfshirë aktet e dhunës, abuzimit fizik, kontrollit dhe dëmtimit të pronës;
- Ngacmimi juridik përfshirë arrestimin ose ndalimin arbitrar, ndërhyrjen e paligjshme në komunikime, abuzimin me procedimet dhe kërcënimet penale, civile dhe administrative;
- Trajtimi diskriminues përfshirë kërkesat jo-proporcionale të raportimit për OSHC-të.

2021:

4 – plotëson shumicën e standardeve

2023:

4 – plotëson shumicën e standardeve

Vlerësimi i vitit 2023 nuk tregon ndonjë ndryshim nga vlerësimi i vitit 2021. **Kodi Penal**¹⁶ dhe Ligji Për Lirinë e Asocimit¹⁷ në OJQ-të **vazhdon të ofrojë ndihmë thelbësore për OSHC-të kundër një game kërcënimesh**, sulmeve, ngacmimit ligjor, dhe trajtimit diskriminues. Kodi Penal në ndalimet e përgjithshme kundër akteve të dhunës, ngacmimit dhe diskriminimit mbron të gjithë entitetet, përfshirë edhe OSHC-të. Është e rëndësishme të theksohet se, ndryshe nga organizatat ndërkombëtare që përfitojnë nga mbrojtje specifike të përcaktuara në Kodin Penal, OSHC-të lokale nuk kanë mbrojtje të tillë të shprehur në mënyrë eksplicite. Sidoqoftë, OSHC-të lokale janë të mbrojtura në kuadrin e mbrojtjes së përgjithshme nga Kodi. Për shembull, megjithëse **Kodi nuk përmend specifikisht mbrojtje për OSHC-të** nga sulmet, **ai kriminalizon dhe penalizon sulmet në përgjithësi**, aplikuar kjo për të gjithë individët, pavarësisht nga entiteti që i përkasin.

Treguesi 1.2.c: Pjesa e OSHC-ve që operojnë efektivisht, pa kërcënime, sulme, ngacmime juridike dhe trajtim diskriminues, në kuptimin e:

- Numrit të ankesave për mungesën e mbrojtjes për OSHC-të;
- Numrin e sulmeve mbi OSHC-të dhe anëtarët e tyre;
- Numrin e rasteve të dëmtimit të pronës;
- Numrin e rasteve të trajtimit diskriminues në raportim;
- Numrin e rasteve kur zyrat e OSHC-ve janë kontrolluar në mënyrë të paligjshme, në kuadrin e inspektimeve;
- Numrin e rasteve të ndërhyrjes në komunikimet e OSHC-ve.

Gjetjet e Anketës së OSHC-ve e 2023 theksojnë se **84% e OSHC-ve raportuan se kanë operuar me efektivitet** pa kërcënime, sulme dhe ngacmime gjyqësore, ndërsa 10% e OSHC-ve raportuan se ata kanë pasur kërcënime dhe sulme fizike, sidomos organizatat që operojnë në veriun e Kosovës.

Siguria e pronës është konfirmuar nga 95% e OSHC-ve, ndërsa 2% e OSHC-ve u përgjigjën se ata kanë pasur dëmtim të pronës si pjesë e kërcënimeve dhe sulmeve fizike. Një shumicë prej **97% e të anketuarve thanë se organizata e tyre nuk ka qenë subjekt i kontrolleve dhe inspektimeve të paligjshme**, ndërsa vetëm **1% e të anketuarve thanë se ata kanë qenë**. Integriteti i komunikimit është pohuar nga 89% e OSHC-ve, që nënvizuan respektin për privatësinë e komunikimit dhe se autoritetet nuk kanë ndërhyrë në komunikimet e tyre; ndërsa 4% e OSHC-ve raportuan se ata kanë pasur eksperiencë me autoritetet që kanë ndërhyrë në komunikimet e tyre.

¹⁶ Kodi No. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf>

¹⁷ Ligji no. 06/L-43 Për Lirinë e Asocimit në OJQ-të, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>.

Krahasimisht, **të dhëna nga 2023 tregojnë një përmirësim të vogël** në kushtet operacionale të OSHC-ve krahasuar me 2021, me një rritje prej 9 % përsa i përket incidenteve të raportuara dhe një rritje prej 7% përsa i përket OSHC-ve që nuk kanë përjetuar të kundërtën.¹⁸

Anketa e zyrtarëve publik mbështet gjetjet e anketës së OSHC-ve, me shumicën e të anketuarve që po-hojnë aftësinë e OSHC-ve për të operuar mjaftueshëm të lirë nga kërcënimet ose ndërhyrjet.

OS 1.3. Masat e përdorura për të luftuar ekstremizimin, terrorizmin, pastrimin e parave, ose korrupsionin janë të targetuara dhe proporcionale, në përputhje me qasjen e bazuar në rrezikun, dhe respektojnë standardet e të drejtave të njeriut mbi lirinë e anëtarësimit, tubimit dhe shprehjes.

Treguesi 1.3.a: Masa në të cilën ligjet për të luftuar ekstremizimin, terrorizmin, pastrimin e parave, ose korrupsionin nuk kufizojnë aktivitetet legjitime të OSHC-ve.

2021:

4 – plotëson shumicën e standardeve

2023:

4 – plotëson shumicën e standardeve

Situata në Kosovë lidhur me këto ligje **ngalet e njejtë si në vlerësimin e vitit 2021**. Nuk ka kërkesa specifike në ligjet për luftën kundër ekstremizimit, terrorizmit, pastrimit të parave dhe korrupsionit që kufizojnë aktivitetet e OSHC-ve. Sidoqoftë, OSHC-të janë subjekt i mbikqyrjes dhe kontrollit nga organet shtetërore lidhur me masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ligji Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit¹⁹ vendos kërkesa sfi- duese për OSHC-të, si për shembull staf i certifikuar kundër pastrimit të parave dhe gjurmimi i përfitues- ve, të cilat janë jo praktike për shumë OSHC, sidomos organizatat e vogla komunitare. Të dyja, pastrimi i parave (ML) dhe financimi i terrorizmit (FT) janë vepra penale në Kosovë²⁰.

Indicator 1.3.b: Pjesa e OSHC-ve aftësia e të cilave që të ndërmarrin aktivitete legjitime nuk është kufizuar nga zbatimi i ligjeve për luftën kundër ekstremizimit, terrorizmit, pastrimit të parave dhe korrupsionin, vecanërisht nga:

- Ngacmimi juridik për lidhjen e tyre të supozuar me ekstremizimin, terrorizmin, pastrimin e parave, dhe korrupsionin;
- Kufizimet diskriminuese mbi financimin,
- Autoritetet ose bankat që ndalojnë ata të hapin llogari bankare, dergojnë ose marrin para.

Anketa e OSHC-ve e 2023 zbuloi se 85% e të anketuarve as nuk ishin ngacmuar juridikisht, as nuk kishin pasur kufizime diskriminuese mbi financimin e tyre, as nuk ishin ndaluar të hapnin llogari bankare, duke treguar një **përmirësim të vogël krahasuar me gjetjet e 2021**.¹⁹

98% e të anketuarve nuk kishin pasur ngacmim juridik, ndërsa 1% e OSHC-ve raportuan se ata kanë përjetuar dicka të tillë. Më tej, 90% e OSHC-ve konfirmuan se nuk kanë qenë subjekt i kufizimeve

¹⁸ Vlera në 2021 për treguesin 1.2.c ishte 21%. Pas ri-llogaritjes së situatës bazës për të siguruar saktësinë e saj, vlera e rishikuar për 2021 është 19%.

¹⁹ Ligji NO. 05/L-096 Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12540>

²⁰ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

diskriminuese për shkak të marrjes së fondeve nga një burim specifik, ndërsa **3% thanë se kanë përjetuar kufizime të tilla**. Përveç kësaj, 92% u përgjigjën se ata nuk janë ndaluar nga autoritetet qeveritare ose bankat për të hapur llogari bankare, për të dërguar ose marrë para, ndërsa 4% u përgjigjën se janë ndaluar.

Këto përgjigje (4%) ju përkasin rasteve individuale të OSHC-ve dhe nuk tregojnë për ekzistencën e kufizimeve zyrtare të verifikueshme për/kundër hapjes së një llogarie bankare.

OS 1.4. Autoritetet publike trajtojnë të gjithë OSHC-të në mënyrë të barabartë lidhur me operimet e tyre dhe njësoj si subjektet e tjera (si bizneset për shembull).

Treguesi 1.4.a Masa në të cilën Ligjet (1) nuk ju kërkojnë OSHC-ve të dorëzojnë më shumë raporte dhe informacion dhe (2) nuk i bëjnë OSHC-të subjekt të më shumë inspektimeve dhe sanksioneve se sa subjektet e biznesit, ndërkohë që çdo gjë tjetër është e barabartë.

2021:

5 – plotëson të gjithë standardet

2023:

5 – plotëson të gjithë standardet

Vlerësimi i vitit 2023 zbulon se **nuk ka ndryshime që nga vlerësimi i vitit 2021**. Ligji Për Lirinë e Asociimit në OJQ, përveç detyrimeve për raportim financiar nga OJQ-të me statusin e përfituesit publik si dhe kërkesat lidhur me procesin e regjistrimit, **nuk vendos ndonjë barrë tjetër mbi OSHC-të**.

Raporti i vitit 2023 i BCSDN specifikon kërkesat për OSHC-të nga shteti dhe thekson se në Kosovë OSHC-të kanë kërkesa raportimi të dyfishtë: bilanci financiare për të dyja, Administratën e Taksave dhe Departamentin e Regjistrimit të OJQ-ve, të detyrueshme për organizatat me Statusin e Përfituesit Publik (>100.000 € audit të jashtëm).²¹

21 AML/CFT Regulations and Implications on CSOs in the Western Balkans and Türkiye, faqe 22, në: <chrome-extension://efaidnbmnnnibp-cajpcgclefindmkaj/https://ecnl.org/sites/default/files/2023-10/112-4-FINAL-Policy-Paper-AMLCFT-Regulations-and-Implications-on-Civil-Society-in-WBT.pdf>.

OS 1.5. Autoritetet publike qendrore dhe/ose lokale kanë politika dhe rregulla mundësuese për organizatat e vogla komunitare dhe iniciativat qytetare (organizatat grass-roots).

Treguesi 1.5.a: Organizatat e vogla/lokale komunitare dhe iniciativat qytetare lejohen të operojnë ligjërisht pa u regjistruar.

2021:

5 – plotëson të gjithë standardet

2023:

5 – plotëson të gjithë standardet

Ushtrimi i lirisë së asociimit është mishëruar në dispozitat kushtetuese dhe statutore, të cilat në mënyrë themelore ju mundësojnë individëve të krijojnë dhe operojnë organizata, përfshirë ato me baze komunitare dhe iniciativa qytetare, pa nevojën e regjistrimit. Ky kuadër ligjor që lejon të dyja, subjektet e regjistruara dhe të paregjistruara të funksionojnë pa kufizime, ngelet në fuqi pa ndryshime krahasuar me vlerësimin e bazës së nisjes së 2021.

Në këtë kontekst, mungesa e barrierave ligjore lehtëson një gamë të gjërë të aktiviteteve qytetare, duke mundësuar që organizatat me bazë komunitare të paregjistruara të punojnë me efektivitet për realizimin e objektivave të tyre. Veçanërisht, nuk ka pasur raportime të rasteve të kufizimeve për funksionimin e organizatave dhe iniciativave qytetare të paregjistruara.

Treguesi 1.5.b: Para ligjit, organizatat e vogla komunitare dhe iniciativat qytetare të paregjistruara gëzojnë të njëjtën të drejtë të pjesëmarrjes në vendim-marrje sikurse OSHC-të e regjistruara.

2021:

4 – plotëson shumicën e standardeve

2023:

4 – plotëson shumicën e standardeve

Procesi i konsultimit publik është lehtësuar nëpërmjet një platforme online²², që ofron një mundësi për të gjithë individët për tu regjistruar dhe kontribuar në proceset vendim-marrëse. Rrjedhimisht, organizatat e paregjistruara komunitare dhe lokale, si dhe iniciativat qytetare, kanë mundësi të marrin pjesë në formimin e legjislacionit, akteve nën-ligjore, dhe dokumenteve të tjerë qeveritarë gjatë fazave të propozimit. Në 2023, Qeveria çoi më përpara aksesin dhe përfshirjen në këtë platformë, me vëmendje të veçantë tek personat me aftësi të kufizuar për të siguruar pjesëmarrjen e tyre pa pengesa.

Ndërsa organizatat komunitare/lokale të paregjistruara dhe iniciativat qytetare lejohen të marrin pjesë në procesin e konsultimit publik, njohja formale dhe influenca në kuadrin qeveritar mbetet vetëm për OSHC-të e regjistruara. Ky dallim mbetet i dukshëm në mekanizmat formal të pjesëmarrjes, sikurse është Këshilli për Bashkëpunimin midis Shoqërisë Civile dhe Qeverisë, ku anëtarësia dhe, rrjedhimisht, influenca zyrtare ju përket ekskluzivisht OSHC-ve të regjistruara.

22 Platforma e Konsultimit Publik, në: <https://konsultimet.rks-gov.net/index.php>

OS 1.6. Të gjithë OSHC-të janë të lira të kërkojnë dhe të marrin fonde.

Treguesi 1.6.a: Masa në të cilën ligjet lejojnë OSHC-të të kërkojnë një gamë të gjerë financimi, përfshirë nga jashtë vendit, pa kufizime të pajustificuara, lidhur me:

- Donacionet në para apo në natyrë nga të gjithë burimet;
- Financimi nga institucionet publike vendase;
- Financimi nga donatorët institucional, korporativ apo individual;
- Financimi nga qeveritë e huaja apo agjensitë shumë-palëshe.

2021:

5 – plotëson të gjithë standardet

2023:

5 – plotëson të gjithë standardet

Vlerësimi i 2023 tregon se **nuk ka ndryshime që nga vlerësimi i fundit i bërë në vitin 2021.**

Ligji Për Lirinë e Asocimit në OJQ **krijon një kuadër të gjërë për funksionimin** e organizatave jo-qeveritare, përfshirë një diversitet të burimeve të financimit si donacionet, procedurat e sigurimit, letrat me vlerë, trashigimitë, anëtarësia, dhuratat, grantet, pasuria e luajtshme dhe e paluejtshme, fitimet nga investimet, dhe fitimi nga aktivitete të ligjshme duke përdorur asetet e OJQ-së.

Ato gjithashtu ofrojnë për burimet e financimit për OJQ-të përfshirë donacionet, procedurat e sigurimit, letrat me vlerë, trashigimitë, anëtarësia, dhuratat, grantet, pasuria e luajtshme dhe e paluejtshme, fitimet nga investimet, dhe fitimi nga aktivitete të ligjshme duke përdorur pronat dhe mjetet e tyre.

Treguesi 1.6.b: Përqindja e OSHC-ve që kanë akses në një gamë të gjërë financimi pa ndërhyrjen e pajustificuar të qeverisë.

Sipas Anketës së OSHC-ve, në 2023, **92% e OSHC-ve në Kosovë raportuan se nuk kanë pasur ndonjë ndërhyrje nga qeveria** që t'i pengojë ato nga aksesit në fonde, kurse 1% e OSHC-ve konfirmuan se ata kanë përjetuar një gjë të tillë. Kjo nënkupton një **përmirësim prej 12%** krahasuar me Vlerësimin e vitit 2021.²³

23 Vlerësimi i situatës bazë është ndryshuar për të reflektuar një aplikim më rigoroz të kritereve të treguesve.

OS 1.7. Në përfituesit e IPA, ekziston mbështetja publike financiare dhe jo-financiare për OSHC-të dhe ajo ofrohet në një mënyrë transparente, të përgjegjshme, të drejtë dhe jo-diskriminuese.

Treguesi 1.7.a: Niveli i financimit publik për OSHC-të dhe shoqatat është rregulluar qartësisht në ligjet dhe rregulloret dhe të drejtat dhe detyrimet e institucioneve shtetërore përgjegjëse për vendosjen dhe rishikimin e nivelit të financimit publik janë përcaktuar qartë në Ligj.

2021:

4 – plotëson shumicën e standardeve

2023:

4 – plotëson shumicën e standardeve

Legjislacioni përkatës përcakton se çdo ofrues i mbështetjes financiare publike (institucione qendrore apo lokale) duhet të përfshijë një mbështetje financiare të tillë brenda kuadrit të linjave të vecanta buxhetore. Kjo do të thotë se **shuma e mbështetjes financiare publike për projektet e programet e OJQ-ve duhet planifikuar gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit vjetor të qeverisë**, ose në buxhetin e ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike, në rastet kur këto institucione nuk janë institucione buxhetore (për shembull, ndërmarrjet publike, fondet e pavarura, ose institucione të ngjashme).

Treguesi 1.7.b: Përqindja e buxhetit publik e dhënë në vit për OSHC-të.

Raporti Vjetor për 2022 tregon se shuma totale e fondeve të ndara për OSHC-të nga Qeveria/ Ministritë/Bashkitë ishte €8,791,340.00. Nga kjo, Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë dhanë €4,866,022.00, Bashkitë kontribuan me €3,951,219.00.

Treguesi 1.7.c: Masa në të cilën kërkesat ligjore që rregullojnë dhënien e fondeve publike për OSHC-të sigurojnë që:

- Kriteret e financimit janë përcaktuar qartë, objektivë dhe të njoftuar publikisht;
- Vlerësimi i propozimeve është i qartë dhe paanshëm;
- Konflikti i interesit është rregulluar qartësisht;
- Kërkesat e raportimit janë të qarta dhe proporcionale.

2021:

4 – plotëson shumicën e standardeve

2023:

4 – plotëson shumicën e standardeve

Lidhur me kriteret e financimit dhe vlerësimin e propozimeve, Raporti i BCSDN për 2022 thekson se në Kosovë zbatimi i Rregullores së vitit 2017 për financimin publik të OJQ-ve po përmirësohet gradualisht në të gjithë nivelet, vecanërisht lidhur me thirrjet publike, komisionet e përzgjedhjes dhe transparencën e kriterëve dhe përfituesve²⁴.

Nuk ka pasur ndryshim përsa i përket konfliktit të interesit të shprehur në vlerësimin e vitit 2021. Mbetet sfida rishikimi i rregulloreve që adresojnë çeshtjet e konfliktit potencial të interesit.

²⁴ Faqe 21 në Monitoring Matrix on Enabling Environment for Civil Society, 2022, në: [chrome-extension://efaidnbnmnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.balkancsd.net/novo/wp-content/uploads/2023/04/62-3-MM-Regional-Report-2022.pdf](https://www.balkancsd.net/novo/wp-content/uploads/2023/04/62-3-MM-Regional-Report-2022.pdf).

Treguesi 1.7.d: Qeveria qendrore bën informim mbi grantet publik që është mjaftueshëm i detajuar që të mundësojë identifikimin e granteve individuale.

2021:

4 – plotëson shumicën e standardeve

2023:

4 – plotëson shumicën e standardeve

Nuk ka pasur ndryshim që nga vlerësimi i vitit 2021, sepse të dhëna të detajuara mbi grantet e dhëna dhe mbështetja tjetër vazhdojnë të publikohen në një platformë zyrtare të freskuar që mirëmbahet nga qeveria e Kosovës²⁵. Sidoqoftë, për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe raportimit të rregullt, ky informacion mund të gjendet vetëm në periudha të caktuara gjatë vitit, ose kur del raporti final në mars të çdo viti. Sidoqoftë, anketa e zyrtarëve publikë e vitit 2023 tregon se pothuaj gjysma e të anketuarve vlerësojnë se autoritetet publike e bëjnë publik informacionin mbi dhënien e fondeve publike për OSHC-të.

Në mënyrë të ngjashme, institucionet publike të Kosovës vazhdojnë të publikojnë thirrjet e tyre në faqet e tyre të internetit²⁶ dhe mediat sociale. Sidoqoftë, një sfidë që vazhdon është se jo i gjithë informacioni publikohet në një platformë dhe do të ishte një ndihmë nëse qeveria i publikon thirrjet në një vend.

Treguesi 1.7.e: Pjesa e OSHC-ve që tregon se dhënia e fondeve publike vendase është transparente, e drejtë dhe jo-diskriminuese.

2021:

1 – nuk i plotëson standardet²⁷	18%
---	------------

2023:

2 – plotëson standardet minimalisht	35%
--	------------

Megjithëse është akoma e vogël përqindja e OSHC-ve që thonë se dhënia e fondeve publike kombëtare është transparente dhe e drejtë, 35%, të dhënat e 2023 tregojnë për një ndryshim pozitiv prej 17 % krahasuar me 2021.

Sipas Anketës së zyrtarëve publikë, të gjithë të anketuarit të cilët konfirmuan se institucioni/agjensia e tyre ofron fonde për OSHC-të thanë se autoritetet mjaftueshëm ose plotësisht kanë shpërndarë informacionin mbi ndarjen e fondeve publike për OSHC-të.

Një e treta e zyrtarëve publikë që morën pjesë në anketën e zyrtarëve publikë dhanë fonde dhe mbështetjen financiarisht OSHC-të gjatë 2023. Pjesa dërmuese e tyre konsiderojnë se këto fonde janë dhënë në mënyrë të drejtë dhe transparente.

25 Rregullore No 04/2017 Për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OSHC-ve, në: <http://ojqfinancime.rks-gov.net/en/220-2/>

26 Thirrjet publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, në: [Public calls for financing of NGO projects – Public Financial Support for NGOs \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)

27 Vlerësimi i situatës bazë është ndryshuar për të reflektuar një aplikim më rigoroz të kriterëve të treguesve.

Treguesi 1.7.f: Financimi publik nuk përjashton OSHC-të bazuar në përfaqësimin e grupit të synuar.

Në 2023, 65% e OSHC-ve aplikuan për fonde publike, krahasuar me 61% në 2021. Ky trend në rritje sugjeron një ndryshim të vogël pozitiv, por jo të ndjeshëm, prej 4% gjatë dy viteve të angazhimit të OSHC-ve me mekanizmat e financimit publik.

65% e OSHC-ve aplikuan për financim në 2023, ndërsa 34% thanë se nuk kanë aplikuar. Nga OSHC-të që kanë aplikuar për financim, 65% thanë se aplikimi i tyre ishte i pasuksesshëm dhe, lidhur me arsyet, 23% thanë se autoritetet nuk duan të financojnë punën me njerëzit që ata ju shërbejnë dhe përfaqësojnë. 39% e tyre punojnë në të drejtat e njeriut, 13% në përfshirjen sociale dhe 13% në të drejtat e minoritetit dhe anti-diskriminimin. 13% e të anketuarve u përgjigjën se procedura e aplikimit është shumë e komplikuar, duke shënuar një përmirësim të vogël krahasuar me 20% që raportuan kështu në 2021.

Pyetjes se përse organizata nuk ka aplikuar për fonde publike, 23% e të anketuarve u përgjigjën se nuk kishin nevojë për financim publik, ndërsa 26% nuk mendonin se kishin një shans real për të fituar. Një tjetër 29% u përgjigjën se fondet e ofruara nga financimet publike ishin shumë të vogla.

Anketa e zyrtarëve publik ofrojnë perspektive tjetër, ku shumica e të anketuarve ishin të mendimit se dhënia e fondeve publike për OSHC-të ishte përfshirëse.

OS 1.8. Individët dhe biznesi gëzojnë lehtësira fiskale për donacionet e tyre për OSHC-të.

Treguesi 1.8.a: Legjislacioni mbi taksat lejon për lehtësira fiskale lidhur me:

- Donacionet individuale;
- Donacionet nga biznesi.

2021:

5 – plotëson të gjithë standardet

2023:

5 – plotëson të gjithë standardet

Vlerësimi i vitit 2023 tregon se nuk ka ndryshim që nga vlerësimi i fundit i bërë në 2021.

Sikurse edhe në raportin e kaluar, individët dhe bizneset kanë të njëjtat përfitime lidhur me taksat për donacionet e tyre për OSHC-të. Individët mund të kenë lehtësira fiskale për donacionet që bëjnë për OSHC-të. Bazuar në Ligjin No. 05/L-028 Për Tatimin mbi të Ardhurat Personale, Neni 28 specifikon se lejohet deduktimi i taksave për aktivitetet e interesit publik²⁸.

Kontributet e bëra nga taksapaguesit në formën e donacioneve konsiderohen si kontribute të dhëna për interes publik dhe lejohen si shpenzime deri në maksimumi dhjetë përqind (10%) të të ardhurave të taksueshme të llogaritura para se ky kontribut është deduktuar. Të njëjtat kritere aplikohen edhe për bizneset/korporatat. Ata kanë lehtësira fiskale për donacionet që bëjnë për OSHC-të me aktivitete të interesit publik.

28 Ligji No. 05/L-028 Për Tatimin mbi të Ardhurat Personale, Neni 28, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11014>

Treguesi 1.8.b: Pjesa e individëve privat që kanë dhënë para tek një OSHC.

Sipas Charities Aid Foundation World Giving Index 2023²⁹, pjesa e individëve privatë që kanë dhuruar para për një OSHC në Kosovë ishte 51%.

OS 1.9. Ka lehtësira fiskale për OSHC-të.

Treguesi 1.9.a: Masa në të cilën ligjet mbi taksat ofrojnë lehtësirat e duhura fiskale për OSHC-të:

- Të ardhurat e gjeneruara nga OSHC-të nga grantet, donacionet, dhe anëtarësia, nga veprimtaria ekonomike, investimet, pasuritë, dhuratat dhe trashëgimia nuk janë subjekt i taksimit;
- Çdo e ardhur ose fitim shtesë të gjeneruara nga aktiviteti ekonomik dhe të përdorura nga OSHC-të për qëllime që lidhen me misionin nuk janë subjekt i taksës të të ardhurave/fitimit të biznesit.

2021:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

2023:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

Vlerësimi i vitit 2023 tregon se nuk ka ndryshim që nga vlerësimi i fundit i bërë në 2021.³⁰

Ligjet përkatëse ofrojnë lehtësira fiskale për OSHC-të dhe fitimi i gjeneruar nëpërmjet aktivitetit ekonomik dhe që përdoret për qëllime të lidhura me misionin dhe të përdorura ekskluzivisht për përfitim publik nuk është subjekt i tatimit mbi të ardhurat/fitimit të biznesit.³¹ Sipas Ligjit Për Tatimin mbi të Ardhurat e Biznesit (Corporate Income Tax - CIT)³², të ardhurat e OSHC-ve nga grantet përjashtohen nga CIT për sa kohë që OSHC ka statusin e përfituesit publik dhe fondet janë përdorur për qëllimet e aktiviteteve të përfitimit publik.

Specifikisht, Neni 8. Të ardhurat e përjashtuara thotë se “me përjashtim të rasteve që parashikohen në Nenin 34 të këtij Ligji, të ardhurat e organizatave të regjistruara sipas Ligjit Për Regjistrimin dhe Operimin e Organizatave Jo-qeveritare që kanë marrë dhe mbajtur statusin e përfituesit publik, për sa kohë që të ardhurat janë përdorur ekskluzivisht për qëllimet e përfitimit publik”. OSHC-të që janë me anëtarësi dhe kanë të ardhura nga kuotat e anëtarësisë nuk duhet të paguajnë taksa mbi kuotat e anëtarësisë, për sa kohë që OSHC-ja mban statusin e përfituesit publik dhe fondet janë përdorur ekskluzivisht për qëllimet e aktiviteteve të përfitimit publik, ose për ofrimin e shërbimeve për anëtarët, me kusht që çmimi është më i ulët se çmimet e tregut.

Neni 8 specifikon se të ardhurat nga grantet, subvencionet dhe donacionet që janë në përputhje me rregullat dhe kushtet e përfitimit duhet të përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat e biznesit.

Administrata e Taksave e Kosovës rezervon të drejtën të vendose taksa nëse verifikon se aktivitetet e OJQ-së janë të një natyre tregëtare dhe jo për përfitim publik. Kjo e drejtë ushtrohet kur ka raste që fitimi i OJQ-së është shpërndarë për të rritur të ardhurat e stafit, si për shembull rritje të rrogave dhe pagesave të tjera, ose ka vendosur çmime më të larta për mallra dhe shërbime se sa çmimet e tregut.

Përveç kësaj, një taksë 10% aplikohet mbi fitimin në rastin e aktiviteteve tregëtare. OSHC-të duhet të paguajnë tatim mbi të ardhurat që gjenerojnë nëpërmjet aktiviteteve ekonomike/të sipërmarrjeve sociale, dhe kjo është rregulluar me Ligjin Për Tatimin mbi të Ardhurat e Biznesit, Neni 34.

29 Charities Aid Foundation World Giving Index 2023, në: <https://www.cafonline.org/about-us/research/caf-world-giving-index>

30 Vlerësimi i situatës bazë nisjes është ndryshuar për të reflektuar një aplikim më rigoroz të kriterëve të treguesve.

31 Ligji No. 05/L-028 Për Tatimin mbi të Ardhurat Personale <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11014>

32 Ligji No. 06/L-105 Për Ligji No. 05/L-028 Për Tatimin mbi të Ardhurat e Biznesit <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20988>

OS 1.10. Politikat dhe mjedisi ligjor ofrojnë insentiva dhe lehtësojnë vullnetarizmin dhe punësimin në OSHC.

Treguesi 1.10.a: Janë adoptuar ligje që rregullojnë vullnetarizmin.

2021:

1 – nuk i plotëson standardet

2023:

1 – nuk i plotëson standardet

Vlerësimi i vitit 2023 tregon se nuk ka ndryshim që nga vlerësimi i fundit i bërë në 2021.³³ Kosova akoma nuk ka një Ligj Për Vullnetarizmin. Sidoqoftë, një Koncept Dokument Për Vullnetarizmin është duke u zhvilluar, i cili prezanton një përmbledhje të Konceptit për draftimin dhe adaptimin nga qeveria e Kosovës të një politike për të promovuar vullnetarizmin nëpërmjet një kuadri të plotë ligjor dhe institucional.³⁴

Situata ngelet e njëjtë si në 2021, kur ligji i vetëm që përmend vullnetarizmin ishte Ligji No. 03/L-145 Mbi Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë.³⁵

Sidoqoftë, ai ju referohet moshave 15 deri në 24, dhe kufizimi i moshës përfaqëson një pengesë serioze për punën vullnetare dhe përfshirjen e barabartë.

Treguesi 1.10.b: Strategjitë dhe programet e qeverisë për vullnetarizmin mbështesin vullnetarizmin tek OSHC-të dhe kanë ndarë burime të mjaftueshme për zbatimin.

2021:

2 – plotëson standardet minimalisht

2023:

2 – plotëson standardet minimalisht

Vlerësimi i vitit 2023 tregon se nuk ka ndryshim që nga vlerësimi i fundit i bërë në 2021.³⁶ Sidoqoftë, duhet shtuar se Koncept Dokument Për Vullnetarizmin është duke u zhvilluar nga Zyra për Qeverisje të Mirë.

Në 2023, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve adoptoi Strategjinë Shtetërore Për Rininë 2024–2032³⁷, një dokument i plotë që përfshin vizionin, qëllimet afat-mesme, masat prioritare të politikës, dhe veprimet specifike, përfshirë zhvillimin dhe promovimin e vullnetarizmit dhe punës vullnetare, që synojnë përmirësimin e mirëqenies dhe pozitës shoqërore të të rinjve.

33 Vlerësimi i situatës bazë është ndryshuar për të reflektuar një aplikim më rigoroz të kriterëve të treguesve.

34 Zyra e Kryeministrit. Lista e koncept dokumenteve për 2024, linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/lista-e-koncept-dokumente-ve-2024/>

35 LIGJI NO. 03/L-145 PËR FUQIZIMIN DHE PJESËMARRJEN E RINISË. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2654>. Accessed 8 Nov. 2022.

36 Vlerësimi i situatës bazë është ndryshuar për të reflektuar një aplikim më rigoroz të kriterëve të treguesve.

37 Strategjia Shtetërore e Rinisë 2024–2032, linku: <https://ëëë.mkrs-ks.org/?page=2,44>

Treguesi 1.10.c: Pjesa e OSHC-ve që përfitojnë nga strategjitë dhe programet shtetërore të punësimit.

Krahasuar me gjetjet e 2021, nuk ka ndonjë përmirësim të rëndësishëm.

Sipas të dhënave të mbledhura nëpërmjet Anketës së OSHC-ve të vitit 2023, vetëm 17% e OSHC-ve të Kosovës raportojnë se kanë përfituar nga inisiativat e punësimit të qeverisë. Shembuj janë punonjësit e projekteve, praktikantët e angazhuar për tre dhe gjashtë muaj, dhe punësimi nëpërmjet platformës së qeverisë Superpuna.³⁸

Pjesa tjetër, 79% e OSHC-ve, u përgjigjën se nuk kanë përfituar nga programet e punësimit të qeverisë.

Treguesi 1.10.d: Pjesa e OSHC-ve që përfitojnë nga strategjitë dhe programet shtetërore të vullnetarizmit.

Sipas Studimit mbi Vullnetarizmin në Kosovë të Zyrës për Qeverisje të Mirë, përsa i përket përfitimit prej financimit të qeverisë në mbështetje të vullnetarizmit në sektorin e OSHC-ve, vetëm 4% e OSHC-ve u përgjigjën se kanë përfituar, ndërsa 92% u përgjigjën që nuk kanë përfituar.³⁹

Treguesi 1.10.e: Pjesa e punonjësve të OSHC-ve në numrin e përgjithshëm të të punësuarve.

Sipas Raportit Vjetor 2022 të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, 24,710 punonjës janë formalisht angazhuar nga OJQ-të. Krahasuar me 2021, raporti thekson se në 2022 janë angazhuar me pak njerëz. Agjensia e Statistikave e Kosovës raportoi një fuqi punëtore prej 403,813 në 2022, çfarë do të thotë se punonjësit e OJQ-ve përfaqësojnë 6.78 % të fuqisë punëtore.

Treguesi 1.10.f: Përqindja e njerëzve që kanë qenë vullnetarë në një organizatë.

Sipas Charities Aid Foundation World Giving Index 2023⁴⁰, në 2023, 8% e njerëzve ishin vullnetarë në një organizatë në Kosovë. Ky informacion tregon për një rënie të vullnetarëve, krahasuar me 10% të raportuar në 2021.

38 Superpuna është një platformë punësimi e krijuar nga qeveria e Kosovës në kuadër të Skemës së Garancive Rinore të Punës. Platforma synon të lehtësojë aksesin e të rinjve në tregun e punës dhe njëkohësisht të ndihmojë bizneset në angazhimin e punonjësve të rinj, linku: <https://superpuna.rks-gov.net/>

39 Zyra për Qeverisje të Mirë, Studim mbi vullnetarizmin në Kosovë 2022, linku: <https://zqm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Vullnetarizmi%20n%C3%AB%20Kosov%C3%AB-%20Studimi-2-99-split-merge.pdf>

40 Charities Aid Foundation World Giving Index 2023, available at: <https://www.cafonline.org/about-us/research/caf-world-giving-index>



Objektivi Specifik 2

Bashkëpunim dhe partneritet i fuqizuar midis OSHC-ve dhe institucioneve publike.

OS 2.1. Autoritetet dhe institucionet publike përfshijnë OSHC-të në proceset vendim-marrëse dhe politikë-bërëse.

Treguesi 2.1.a: Ligjet, aktet nën-ligjore, strategjitë dhe aktet e tjera të interesit publik dhe reformat e politikave janë konsultuar efektivisht me OSHC-të lidhur me:

- OSHC-të kanë akses në draft-dokumentet që nga fillimi i procesit të përgatitjes deri në fund të procedurës së aprovimit;
- Të paktën 15 ditë janë lënë për komentim përpara se draft-dokumenti të kalojë në procedurat e aprovimit;
- Përdorimi i procedurave të jashtëzakonshme/përshpejtuara për adoptimin e legjislacionit pa mundësinë e konsultimit është një përjashtim dhe i justifikuar si duhet;
- Raportet mbi rezultatet e konsultimeve publike, përfshirë arsyet për mos-marrjen parasysh të komenteve, janë publikuar në kohë;
- Anëtarët e grupeve të punës nga OSHC-të janë përzgjedhur bazuar në një thirrje publike, kritere të qarta dhe barazinë;
- Anëtarët e grupeve të punës nga OSHC-të përfshijnë përfaqësues të shoqërisë si e tërë, përfshirë grupet e grave, LGBTIQ+, migrantëve, minoriteteve, pa-afetësisë dhe të tjerë, në përputhje me Qasjen e Bazuar në të Drejtat e Njeriut.

2021:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

2023:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

Përditësimi i vitit 2022 i Rregullave të Procedurës të Kuvendit të Kosovës⁴² ka zgjeruar fushën për pjesëmarrjen e OSHC-ve në takimet e komisioneve dhe dëgjesat publike të ligjeve. Ky përparim është përforcuar nga platforma online për konsultime publike⁴³, e përditësuar për të qenë më e aksesueshme, veçanërisht për njerëzit me aftësi të kufizuara.

Sipas Raportit Vjetor 2023 të Qeverisë mbi Konsultimet Publike, 244 dokumente janë publikuar dhe ishin të hapura për konsultime, nga të cilat 153 dokumente janë në përputhje me standardet minimale⁴⁴ për konsultimin publik, ndërsa 91 nuk janë. Kjo do të thotë se 62.7% e dokumenteve plotësojnë standardet, ndërsa 37.3% nuk plotësuan kërkesat minimale për konsultimin publik.⁴⁵

Përveç kësaj, vazhdon të ngelet prapa plotësimi i disa standardeve, parimeve dhe procedurave të specifikuar në Standardet Minimale për Konsultimin Publik. Në përgjithësi, konsultimet publike janë bërë në nivel qendror, më shkrim dhe elektronikisht nëpërmjet platformës online. Lidhur me këtë, Raporti i KE

41 The 2021 value for Indicator 2.1.a was 9%. Following the recalculation of the baseline to ensure the accuracy of the value, the revised value for 2021 was 10%.

42 Rregullat e Procedurës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenet 35 dhe 39, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61266>

43 Platforma e Konsultimeve Publike, linku: <https://konsultimet.rks-gov.net>

44 RREGULLORE (GRK) NO. 05/2016 MBI STANDARDET MINIMALE PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK, linku: <https://gzk.rks-gov.net/Act-DocumentDetail.aspx?ActID=15036>

45 COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Kosovo* 2023 Report, available at: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2023_en

për Kosovën 2023 rekomandoi të rritet përdorimi i formave të tjera të konsultimit publik. Administratat lokale nuk i përdorin mjaftueshëm këto mekanizma^{46,47}

Megjithë ndërhyrjet e bëra për të siguruar që procesi i konsultimit është i plotë, përgjigja nga shoqëria civile dhe qytetarët për konsultimet publike nëpërmjet portalit online të konsultimit mbetet relativisht e ulët. Edhe pse të dhënat nga Anketa e OSHC-ve tregojnë një 15% rritje në raportimin e OSHC-ve për konsultim efektiv në draftimin e ligjeve dhe politikave krahasuar me 2021, shifra prej 35% e OSHC-ve që konfirmojnë konsultimet efektive mbetet relativisht e ulët.

Më tej, aplikimi në praktikë i procesit të konsultimit publik nxjerr në pah disa kufizime. Ndërsa platforma është sipas standardeve ndërkombëtare të përfshirjes dhe transparencës, një sfidë e vazhdueshme është që kontributet/komentet e OSHC-ve në platformë shpesh nuk merren në konsideratë nga institucionet përkatëse të qeverisë.⁴⁸

Ndryshe nga kjo, të dhënat e anketës së zyrtarëve publik tregojnë se shumica e të anketuarve thanë se OSHC-të ishin konsultuar mjaftueshëm ose në mënyrë shumë efektive në 2023.

Treguesi 2.1.b: OSHC-të janë përfshirë efektivisht në mekanizmat mbyqyrës.

Ky tregues nuk është rishikuar.

Treguesi 2.1.c: Pjesa e OSHC-ve që kanë marrë pjesë në konsultime gjatë përgatitjes së raporteve shtetërore në kuadrin e detyrimeve ndërkombëtare dhe të tjera lidhur me të drejtat e njeriut dhe zbatimin e rekomandimeve të tyre.

Ky tregues nuk është rishikuar.

46

47 Kosovo 2023 Report, linku: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cd-d65c3_en?filename=SËD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf

48 KLGj Raport Monitorimi i Konsultimeve Publike në Nivel Lokal 2023, linku: <https://ëëë.klgi-ks.com/ëp-content/uploads/2024/04/MONITORING-REPORT-OF-PUBLIC-CONSULTATION-AT-THE-LOCAL-LEVEL-2023-1.pdf>

OS 2.2. Autoritetet dhe institucionet publike pranojnë rëndësinë e shoqërisë civile në debatin shoqëror mbi politikat dhe proceset e integritit në BE.

Treguesi 2.2.a: Masa në të cilën OSHC-të vlerësojnë si mbështetës qëndrimin e zyrtarëve publik kundrejt shoqërisë civile.

2021:

2 – plotëson standardet minimalisht ⁴⁹

2023:

2 – plotëson standardet minimalisht

Anketa e fundit zbulon se 40% e OSHC-ve në Kosovë i shohin zyrtarët publikë si mbështetës të shoqërisë civile, duke shënuar një përmirësim prej 10% krahasuar me 2021. Njëkohësisht, 47% e të anketuarve i shohin zyrtarët publikë si pamjaftueshmërisht mbështetës të shoqërisë civile, duke shënuar një trend negative prej 10%.

Në kontrast me këtë, sipas anketës së zyrtarëve publikë, shumica e ndjeshme e të anketuarve theksuan se ata e konsiderojnë veten si shumë mbështetës të shoqërisë civile.

OS 2.3. Autoritetet publike kontribuojnë në fuqizimin e shoqërisë civile duke bashkëpunuar me shoqërinë civile nëpërmjet kuadrit strategjik të politikave dhe mekanizmave të duhur institucional.

Treguesi 2.3.a: Pjesa e OSHC-ve që janë konsultuar efektivisht gjatë përgatitjes së strategjive të bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile⁵⁰ u adoptua në 2019 dhe ishte zhvilluar për periudhën 2019–2023. Prandaj ky tregues nuk është vlerësuar në 2023. Konsultimet për strategjinë e ardhshme 4-vjeçare do të mbahen gjatë 2024.

Treguesi 2.3.b: Përfituesit e IPA kanë adoptuar strategji të vlefshme të bashkëpunimit me shoqërinë civile.

2021:

5 – plotëson të gjithë standardet

2023:

5 – plotëson të gjithë standardet

Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile⁵¹ u adoptua në 2019 dhe mbulonte periudhën 2019–2023.

49 Korrektim gabimi në raportin mbi situatën bazë

50 Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2019–2023, linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/strategjia-qeveritare-per-bashkepunim-me-shoqerine-civile-2019-2023-16-08-2019/>

51 Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2019–2023, linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/strategjia-qeveritare-per-bashkepunim-me-shoqerine-civile-2019-2023-16-08-2019/>

Treguesi 2.3.c: Strategjitë e bashkëpunimit me shoqërinë civile shoqërohen me plane veprime të buxhetuara.

2021:

5 – plotëson të gjithë standardet

2023:

5 – plotëson të gjithë standardet

Vlerësimi i vitit 2023 tregon se nuk ka ndryshim që nga vlerësimi i fundit i bërë në 2021. Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2019–2023⁵² ishte shoqëruar me një plan veprimi dhe një buxhet, duke përcaktuar objektivat, aktivitetet, periudhat kohore, dhe kostot e zbatimit, institucionet përgjegjëse dhe detaje të tjera të rëndësishme.⁵³

Treguesi 2.3.d: Pjesa e OSHC-ve që vlerësojnë strategjitë e bashkëpunimit me shoqërinë civile si relevante dhe efektive.

Në kontekstin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile dhe efektivitetit të saj në arritjen e objektivave dhe rezultateve, 34% e OSHC-ve deklaruan se strategjia kombëtare për bashkëpunimin me shoqërinë civile ishte edhe relevante edhe efektive.

Këto rezultate shënojnë një **ndryshim të rëndësishëm negativ** në opinionin e OSHC-ve me **20%** krahasuar me të dhënat e 2021.

Treguesi 2.3.e: Strukturave publike, përgjegjëse për zbatimin e strategjive të bashkëpunimit me shoqërinë civile, iu janë dhënë burimet e duhura.

Në 2023, Zyra për Qeverisje të Mirë, e cila është përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile, u përball me sfida lidhur me stafin ose mungesën e stafit teknik të specializuar. Këto rezultate u mbështetën nga gjetjet e Raportit të ZQM për vlerësimin e zbatimit të strategjisë, ku një nga rekomandimet ishte se është thelbësore që të përmirësohen kapacitetet njerëzore të Zyrës për Qeverisje të Mirë për të siguruar mbulimin efektiv të të gjithë fushave të saj të përgjegjësive, sidomos të atyre të lidhura me Strategjinë.

Megjithë një rritje të vogël të stafit nga dy në tre anëtarë dhe disa përmirësime të infrastrukturës dhe burimeve digjitale, zyra ka akoma burime të pamjaftueshme lidhur me kapacitetet e nevojshme për të zbatuar plotësisht mandatin e saj, që gjithashtu përfshin menaxhimin e proceseve të konsultimit publik dhe të konsultimit publik mbi financimin dhe e-platformën e konsultimit publik.

Më tej, ZQM shpesh ndeshet me vështirësi financiare për realizimin e disa prej aktiviteteve kordinuese, sidomos lidhur me kontraktimin e ekspertizës së nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë.²

Anketa e zyrtarëve publikë e 2023 tregoi për perceptimet e ndryshme midis të anketuarve në përgjithësi. Gjysma shprehën shqetësimin mbi burimet e pamjaftueshme njerëzore dhe financiare që duhen për operimin efektiv dhe gjysma tjetër beson se burimet kanë qenë të mjaftueshme.

52 Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2019–2023. linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/strategjia-qeveritare-per-bashkepunim-me-shoqerine-civile-2019-2023-16-08-2019/>

53 Burimi: Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit të Kosovës.

Treguesi 2.3.f: Mekanizmat për dialog midis këshillave të bashkëpunimit të shoqërisë civile dhe qeverisë qendrore përfshijnë OSHC-të në një mënyrë kuptimplotë:

- ata kanë një program pune të dakortësuar
- ata kanë rënë dakort për rregullat e procedurës
- ata takohen rregullisht
- rregullat lejojnë OSHC-të të organizojnë takime dhe kontribuojnë në zhvillimin e axhendës
- ka një ndjekje të duhur të konkluzioneve dhe rekomandimeve.

2021:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

2023:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

Në 2023, Këshilli për Bashkëpunimin e Qeverisë me Shoqërinë Civile⁵⁴, që konsitoi në 29 anëtarë–15 nga OSHC-të dhe 14 nga qeveria, vazhdoi të shërbejë si forumi kryesor për dialogun midis qeverisë dhe OSHC-ve.

Vlerësimi i 2023 tregon se në këtë vit, Këshilli, i mbështetur nga grupet tematike të punës, u përqëndrua në adresimin e hendekut në zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2019–2023. Megjithë sfidat, ka një përmirësim krahasuar me 2021 lidhur me takimet e rregullta dhe angazhimin e OSHC-ve. OSHC-të kanë vlerësuar përfshirjen e tyre si “mjaftueshëm kuptimplotë», duke pranuar organizimin më të mirë të takimeve gjatë dy viteve të fundit.

Sidoqoftë, diskutimi në Grupin Fokus me përfaqësuesit e OSHC-ve tregoi se Këshilli përballet me sfida që e kanë kufizuar efektivitetin e tij në zbatimin e strategjisë. Çështjet kyçe përfshijnë rolin shpesh të kufizuar të Këshillit, rolin e tij kryesisht raportues mbi zbatimin e strategjisë, dhe ndryshimet e shpeshta të anëtarëve nga qeveria, që çojnë në humbjen e memories institucionale. Për të rritur efektivitetin e Këshillit dhe thelluar bashkëpunimin me shoqërinë civile, është thelbësore të adresohen shqetësimet lidhur me operimin e Këshillit, përfshirë ndryshimin e shpeshtë të anëtarëve, dërgimin e zëvendësuesve në takime, dhe zgjedhjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile që më së miri përfaqësojnë interesat e shoqërisë civile. Këto gjetje janë mbështetur nga Raporti i Vlerësimit i ZQM mbi zbatimin e strategjisë⁵⁵, dhe Raporti i CIVIKOS mbi monitorimin e zbatimit të strategjisë së qeverisë për bashkëpunimin me shoqërinë civile 2019–2023⁵⁶.

54 Këshilli për Bashkëpunimin e Qeverisë me Shoqërinë Civile, linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/the-office-of-prime-minister/council-for-cooperation-of-the-government-ëith-civil-society/>

55 Zyra për Qeverisje të Mirë, Raport Vlerësimi mbi zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile, linku: [RAPORTI I VLERËSIMIT TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË QEVERTARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019–2023 – CiviKos](#)

56 CIVIKOS 2023 RAPORT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË QEVERTARË PËR BASHKËPUNIMIN ME SHOQËRINË CIVILE 2019–2023, linku: [REPORT ON MONITORING THE IMPLEMENTATION OF THE GOVERNMENT STRATEGY FOR COOPERATION ËITH CIVIL SOCIETY 2019–2023 – CiviKos](#)



Objektivi Specifik 3

Është përforcuar kapaciteti dhe aftësia e OSHC-ve për të realizuar me efektivitet aktivitetet.

OS 3.1. Strukturat e qeverisjes së brendshme të OSHC-ve ndjekin parimet e qeverisjes së mirë

Treguesi 3.1.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë një organ qeverisës të pavarur dhe efektiv me terma reference të qarta për mbikqyrjen e qëllimeve strategjike, ndikimit, menaxhimit, zbatimit të ligjit dhe llogaridhënies së organizatës.

2021:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar	59%
--	------------

2023:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar	45%
--	------------

Anketa e OSHC-ve e 2023 tregon se 45% e OSHC-ve kanë një organ qeverisës të pavarur dhe një dokument qeverisës, duke treguar një rënie prej 14% krahasuar me të dhënat e vitit 2021.⁵⁷

Në 2023, 93.33% e OSHC-ve të Kosovës raportuan se kanë një organ qeverisës, dhe të gjitha OSHC-të e anketuara thane se kanë një dokument qeverisës, si statut, akt themelimi, ose dokument të ngjashëm. Lidhur me pavarësinë e organeve qeverisëse, një përqindje shqetësuese, pothuaj gjysma e të anketuarve ose 49%, raportuan se drejtori ekzekutiv ose anëtarë të tjerë të stafit të paguar ishin anëtarë me të drejtë vote të organit qeverisës.

Treguesi 3.1.b: Pjesa e OSHC-ve që në mënyrë të rregullt shqyrtojnë konfliktin e interesit lidhur me marrdhëniet politike, ekonomike dhe personale të organit të tyre qeverisës.

2021:

2 – plotëson standardet minimalisht	25%
--	------------

2023:

2 – plotëson standardet minimalisht	36%
--	------------

Në 2023, sipas të dhënave, 36% e OSHC-ve kërkojnë që anëtarët e organit qeverisës të nënshkruajnë çdo vit deklaratën e konfliktit të interesit, duke shënuar një rritje prej 11% krahasuar me 2021.

Nga ana tjetër, 44% e OSHC-ve thanë se anëtarëve të organit qeverisës ju është kërkuar të nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit vetëm kur ata marrin detyrën, ndërsa 11% e OSHC-ve raportuan se nuk jua kanë kërkuar asnjëherë anëtarëve të organit qeverisës të nënshkruajnë deklaratën.

⁵⁷ Në 2021 vlera për Treguesin 3.1.a ishte 57%. Pas ri-llogaritjes të situatës bazë duke marrë parasysh heqjen e një pyetje nga anketa, vlera e rishikuar për 2021 është 59%.

Treguesi 3.1.c: Pjesa e OSHC-ve që ndajnë informacionin e duhur mbi organizatën nëpërmjet mjeteve dhe kanaleve që janë të aksesueshme nga të gjithë palët e interesuara përsa i përket publikimit të:

- statuteve të tyre;
- strukturës qeverisëse;
- politikave organizative.

2021:

2 – plotëson standardet minimalisht	23%
-------------------------------------	-----

2023:

1 – does not meet standards	12%
-----------------------------	-----

Në 2023, 12% e OSHC-ve në Kosovë **e kanë bërë informacionin e duhur mbi organizatën të aksesueshëm publikisht**, duke publikuar dokumentet qeverisëse dhe strukturën e bordit të organizatës. Këto rezultate tregojnë për **një rënie prej 11 % krahasuar me rezultatet e vitit 2021**⁵⁸.

Treguesi 3.1.d: Pjesa e OSHC-ve që kanë një politikë organizative të barazisë gjnëore.

2021:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar	50%
---	-----

2023:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar	47%
---	-----

Të dhënat e 2023 tregojnë se 47% e OSHC-ve kanë një politikë të barazisë gjnëore. Kjo përqindje shënon një **rënie të vogël prej 3% krahasuar me rezultatet e raportuara në vitin 2021**.

Treguesi 3.1.e: Pjesa e OSHC-ve që kanë strategji organizative, përfshirë vizionin, misionin dhe qëllimet.

2021:

4 – plotëson shumicën e standardeve	75%
-------------------------------------	-----

2023:

4 – plotëson shumicën e standardeve	74%
-------------------------------------	-----

Sipas të dhënave të Anketës së OSHC-ve të vitit 2023, 74% e të anketuarve pohojnë se kanë një strategji/plan strategjik. Këto të dhëna nuk tregojnë ndonjë ndryshim të madh krahasuar me 2021.⁵⁹

⁵⁸ Në 2021 vlera për Treguesin 3.1.c ishte 29%. Pas ri-llogaritjes të situatës bazë duke marrë parasysh heqjen e një pyetje nga anketa, vlera e rishikuar për 2021 është 23%.

⁵⁹ Në 2021 vlera për Treguesin 3.1.e ishte 69%. Pas ri-llogaritjes të situatës bazë nisjes duke marrë parasysh heqjen e një pyetje nga anketa, vlera e rishikuar për 2021 është 75%.

OS 3.2. OSHC-të janë të afta të komunikojnë rezultatet e aktiviteteve të tyre tek publiku.

Treguesi 3.2.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë të paktën një kanal on-line komunikimi.

2021:

5 – plotëson të gjithë standardet	95%
-----------------------------------	-----

2023:

5 – plotëson të gjithë standardet	96%
-----------------------------------	-----

Sipas Anketës së OSHC-ve të 2023, **96% e të anketuarve nga OSHC-të** kanë përdorur të paktën një kanal komunikimi online për të **ndarë rregullisht punën e tyre me publikun**. Nuk ka një ndryshim të ndjeshëm krahasuar me Anketën e bërë në 2021. 48% e OSHC-ve thanë se kanë përdorur faqen e tyre të internetit për komunikim.

Facebook ngelet ndjeshëm kanali më popullor i komunikimit, me **91%** që e përdorin atë, i ndjekur nga Instagram, me 46%. LinkedIn dhe mesazhet përdoren nga rreth 20% oe OSHC-ve.

Treguesi 3.2.b: Pjesa e OSHC-ve që kanë staf komunikimi të specializuar.

Ky tregues nuk është vlerësuar.

Treguesi 3.2.c: Pjesa e OSHC-ve që bashkëpunojnë me median.

Në 2023, 29% e OSHC-ve në Kosovë raportuan se janë angazhuar në partneritet me dhe bashkëpunojnë me median, duke shënuar një rënie prej 5 % krahasuar me 2021.

OS 3.3. OSHC-të janë transparente rreth aktiviteteve programatike dhe burimet e financimit.

Treguesi 3.3.a: Pjesa e OSHC-ve që publikojnë raportet e tyre vjetore dhe bilanci financiar.

2021:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar	48%
---	-----

2023:

2 – plotëson standardet minimalisht	37%
-------------------------------------	-----

Në 2023, 37% e OSHC-ve raportuan se kanë publikuar të dyja, edhe raportet vjetore edhe bilanci financiar, duke shënuar një rënie prej 11 % krahasuar me 2021.⁶⁰

Përsa i përket dokumenteve individuale, 48% e OSHC-ve kanë nxjerrë raport vjetor, dhe 44% kanë ndarë bilanci financiar. Sidoqoftë, 33% e OSHC-ve nuk kanë publikuar asnjë lloj dokumenti. Përgjigjet nga OSHC-të që nuk kanë publikuar as raportin vjetor dhe as bilanci financiar ndryshojnë, por shumica theksuan aktivitetin minimal financiar. Të tjerët theksuan vonesat burokratike, mungesën e aktivitetit organizativ, dhe fokusin në komunikimin me palët e interesuara të targetuara në vend të publikimit të gjërë, por se në çdo rast raporti vjetor është dorëzuar rregullisht tek Administrata e Taksave dhe Zyra për Regjistrimin e OJQ-ve.

Përsa i përket metodave të shpërndarjes, 37% e OSHC-ve kanë publikuar informacionin e tyre online dhe një tjetër 37% deklaruan se e kanë shpërndarë të printuar, ndërsa 45% kanë dorëzuar raportet e tyre tek regjistrat zyrtare qeveritarë.

Treguesi 3.3.b Pjesa e OSHC-ve që publikojnë informacionin mbi burimet e financimit dhe shumat e marra në vitin paraardhës.

2021:

2 – plotëson standardet minimalisht	27%
-------------------------------------	-----

2023:

1 – nuk i plotëson standardet	20%
-------------------------------	-----

Lidhur me publikimin e burimeve të financimit dhe shumat e marra për vitin paraardhës, 20% kanë publikuar detaje mbi burimet e financimit dhe shumat e marra, duke përfaqësuar një rënie prej 7% krahasuar me 2021.

Një detajim i mëtejshëm tregon se, nga ky 20%, 53% kanë ndarë informacionin mbi burimet e financimit, ndërsa 25% kanë dhënë detaje për shumat e marra. 28% nuk publikuan informacion për asnjërën.

Anasjelltas, 28% e OSHC-ve të anketuara raportuan se nuk kanë publikuar këtë informacion.

Treguesi 3.3.c: Shkalla e besimit publik në OSHC-të.

Sipas Balkan Public Barometer, **shkalla e besimit publik në OSHC-të është vlerësuar në 50%** për Kosovën.⁶¹

⁶⁰ Në 2021 vlera për Treguesin 3.3.a ishte 38%. Pas ri-llogaritjes të situatës bazë duke marrë parasysh heqjen e një pyetje nga anketa, vlera e rishikuar për 2021 është 48%.

⁶¹ Balkan Public Barometer 2023 Index, linku: <https://www.rcc.int/balkanbarometer/results/2/public>

OS 3.4. OSHC-të monitorojnë dhe vlerësojnë rezultatet dhe ndikimin e punës së tyre.

Treguesi 3.4.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë bërë një vlerësim të punës së tyre vitin e kaluar.

2021:

4 – plotëson shumicën e standardeve	72%
-------------------------------------	-----

2023:

4 – plotëson shumicën e standardeve	75%
-------------------------------------	-----

Sipas Anketës së OSHC-ve të 2023, 75% e OSHC-ve raportuan se gjatë vitit të kaluar kanë vlerësuar aspekte të punës së tyre, si projektet, strategjitë, ose proceset e brendshme, duke shënuar një rritje të vogël prej 3% krahasuar me 2021.⁶²

Lidhur me pyetjen nëse në 2023 organizata ka bërë një vlerësim të brendshëm ose të jashtëm të ndonjë projekti, strategjie, procedure të brendshme, apo ndonjë elementi tjetër, 65% thanë se kanë vlerësuar projektet e tyre, 28% thanë se kanë vlerësuar strategjitë, dhe 32% që kanë vlerësuar proceset e brendshme.

Rreth 15% thanë se nuk kanë bërë ndonjë vlerësim. Arsyeja nga OSHC-të që nuk kanë bërë ndonjë vlerësim ishte kryesisht se nuk kanë pasur projekte në 2023.

62 Në 2021 vlera për Treguesin 3.4.a ishte 55%. Pas ri-llogaritjes të situatës bazë duke marrë parasysh heqjen e një pyetje nga anketa, vlera e rishikuar për 2021 është 72%.

OS 3.5. OSHC-të përdorin kërkimin dhe evidencën për të mbështetur punën e tyre.

Treguesi 3.5.a: Pjesa e OSHC-ve puna e të cilave është bazuar në evidencën e gjeneruar nëpërmjet kërkimit.

2021:

5 – plotëson të gjithë standardet	88%
-----------------------------------	-----

2023:

4 – plotëson shumicën e standardeve	80%
-------------------------------------	-----

Ne Anketën e OSHC-ve të 2023, 80% e OSHC-ve u përgjigjën se kanë përdorur një lloj kërkimi për të grumbulluar informacion mbi punën e tyre, duke shënuar një rënie prej 8% krahasuar me anketën e 2021⁶³.

Pyetjes se çfarë lloj kërkimi ka bërë organizata e tyre për të grumbulluar informacion mbi punën e tyre, 51% u përgjigjën se takimet me grupet fokus kanë qënë metoda më e përdorur. 38% e të anketuarve u përgjigjën se ata kanë përdorur kërkimin në terren, ndërsa 23% kanë përdorur kërkimin në zyrë.

Anketat me grupe specifike janë përdorur nga 36% e OSHC-ve, por anketat e opinionit publik ishin më të pakta, me vetëm 24% të OSHC-ve që i kanë përdorur ato. Pyetjes lidhur me arsyet për mungesën e kërkimit, shumica dhanë mungesën e fondeve, mungesën e aktiviteteve të rëndësishme, dhe mungesën e planeve specifike të kërkimit.

13% e OSHC-ve u përgjigjën se nuk kanë bërë kërkim për të grumbulluar informacion për punën e tyre. Arsyeja kryesore për mos ndërmarrjen e ndonjë lloj kërkimi ishte mungesa e projekteve në zbatim dhe mungesa e fokusit në aktivitete specifike kërkimore.

Treguesi 3.5.b: Pjesa e OSHC-ve puna e të cilave mbështetet në konsultimin me njerëzit që kanë një interes në punën e tyre të tanishme ose të ardhshme.

2021:

5 – plotëson të gjithë standardet	90%
-----------------------------------	-----

2023:

5 – plotëson të gjithë standardet	88%
-----------------------------------	-----

Sipas Anketës së OSHC-ve të 2023, 88% e aktiviteteve të OSHC-ve mbështeten në kontributin e palëve të interesuara për arritjen e objektivave të tanishme dhe të ardhshme të organizatës. Këto rezultate janë të ngjashme me ato të raportit të situatës bazë të 2021, duke shënuar një rënie të vogël prej 2%.⁶⁴

Përsa i përket angazhimit të palëve të interesuara, 57% e të anketuarve thanë se kanë angazhuar në mënyrë të barabartë komunitetet lokale dhe anëtarët.

Pothuaj gjysma e organizatave janë konsultuar me autoritetet lokale, kurse 24% me autoritetet kombëtare dhe 35% kanë ndërvepruar me institucionet publike. 6% e OSHC-ve janë konsultuar me përfituesit e tyre dhe komunitetin e donatorëve. 6% e OSHC-ve nuk kanë bërë ndonjë konsultim për arsye të mungesës së burimeve financiare dhe të aktiviteteve në organizatë.

63 Në 2021 vlera për Treguesin 3.5.a ishte 95%. Pas ri-llogaritjes të situatës bazë duke marrë parasysh heqjen e një pyetje nga anketa, vlera e rishikuar për 2021 është 88%.

64 Në 2021 vlera për Treguesin 3.5.b ishte 63%. Pas ri-llogaritjes të situatës bazë duke marrë parasysh heqjen e një pyetje nga anketa, vlera e rishikuar për 2021 është 90%.

OS 3.6. OSHC-të punojnë në partneritete të drejta dhe të respektueshme për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Treguesi 3.6.a: Pjesa e OSHC-ve që marrin pjesë në rrjetet lokale, qendrore dhe ndërkombëtare.

Në 2023, 80% e OSHC-ve ishin pjesë e rrjeteve lokale, kombëtare, ose ndërkombëtare, duke reflektuar një rënie prej 11% krahasuar me 2021.

Duke e detajuar këtë, 47% e të anketuarve ishin pjesë e rrjeteve kombëtare, 44% e rrjeteve lokale dhe 32% e rrjeteve ndërkombëtare. 16% thanë se nuk ishin pjesë e ndonjë rrjeti.

Treguesi 3.6.b: Pjesa e OSHC-ve të angazhuara në partneritete ndër-sektoriale me akademinë, partnerët social dhe sektorin privat.

Sipas Anketës së 2023, përqindja e OSHC-ve të angazhuara në partneritete ndër-sektoriale me akademinë, partnerët social dhe sektorin privat ishte 59%, duke shënuar një rënie prej 15% krahasuar me rezultatet e vitit 2021⁶⁵.

Një përqindje e njëjtë, pothuaj 29%, u përgjigjën se organizata e tyre është angazhuar në partneritete me partnerët social, sektorin privat dhe median. Universitetet kishin shkallën më të lartë të partneritetit, duke tërhequr 30% të të anketuarve. Ndërsa 25% e OSHC-ve pohuan se nuk janë angazhuar me ndonjë partner në 2023.

OS 3.7. OSHC-të kanë një financim të diversifikuar.

Treguesi 3.7.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë donatorë të ndryshëm.

2021:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar	53%
---	-----

2023:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar	48%
---	-----

Sipas Anketës së OSHC-ve të 2023, 48% e OSHC-ve kanë diversifikuar të ardhurat nga donatorët. Këto rezultate shënojnë një rënie prej 5% krahasuar me 2021.

Përqindja më e lartë e OSHC-ve, 62%, morën fonde nga fondacionet e huaja private. Analiza më e detajuar e OSHC-ve që kanë marrë fonde në 2023 nga fondacionet e huaja private tregon 11% morën fonde që përbënin më pak se 25% të buxhetit të tyre, ndërsa 14% morën më shumë se gjysma e buxhetit të tyre nëpërmjet kësaj mënyre.

59% e OSHC-ve u përgjigjën se kanë marrë fonde nga qeveria qendrore. Për 18% të këtyre OSHC-ve këto fonde përfaqësonin 10–25% të buxhetit të tyre dhe për 9% të tyre ato mbulonin më shumë se gjysmën e buxhetit të tyre.

52% e OSHC-ve u përgjigjën se kanë marrë fonde nga donatorë bilateralë. Për 17% të tyre ky financim përbënte deri në 25% të buxhetit dhe për 21% të tyre më shumë se 50% të buxhetit të tyre.

Në kuadër të diversifikimit të burimeve të financimit, Komisioni Evropian ishte një donator tjetër i rëndësishëm. 47% e OSHC-ve morën fonde nga KE. 19% e këtyre OSHC-ve që morën fonde nga ky burim thanë se fondet përfaqësonin midis 10% dhe 25% të buxhetit të tyre. Për 15%, këto fonde përfaqësonin më shumë se 50% të buxhetit të tyre.

⁶⁵ Pas ri-llogaritjes të Treguesit 3.6.b të situatës bazë, për të siguruar saktësinë e vlerës, vlera e rishikuar për 2021 është 74%.

Organizatave ndërqeveritare përfaqësojnë një burim financimi për 44% të OSHC-ve. Për 14% të OSHC-ve, fondet nga Kombet e Bashkuara mbulojnë deri në 25% të buxhetit të tyre dhe për 12% më shumë se gjysmën e buxhetit të tyre. OSBE financoi deri në 25% të buxhetit të 8% të OSHC-ve dhe më shumë se 50% të buxhetit të 3% të OSHC-ve.

Fondacionet private të vendit ishin burimi i financimit për 21% të OSHC-ve. Këto fonde përfaqësonin 10-25% të buxhetit për 16% të OSHC-ve dhe më shumë se gjysmën e buxhetit për 4% të OSHC-ve.

52% u përgjigjën se kanë marrë më shumë se 50% të buxhetit të tyre nga një donator i vetëm.

Treguesi 3.7.b: Pjesa e OSHC-ve që sigurojnë fonde nga burime të tjera përveç donatorëve, si kuotat e anëtarësisë, donacionet individuale/nga biznesi, dhe aktivitetet për gjenerimin e të ardhurave.

2021:

4 – plotëson shumicën e standardeve	63%
-------------------------------------	-----

2023:

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar	52%
---	-----

Sipas Anketës së OSHC-ve, 52% e OSHC-ve raportuan se kanë të paktën një burim shtesë të ardhurash, duke shënuar një rënie prej 11% krahasuar me 2021.

Duke u nisur nga këto shifra, donacionet individuale ishin burimi më i madh i të ardhurave, duke mbuluar 1-25% të financimit për 26% të OSHC-ve dhe më shumë se 50% të financimit për 2% të OSHC-ve.

Kjo ndiqet nga të ardhurat nga sektori i biznesit privat, që mbulon 1-25% të financimit për për 22% të OSHC-ve dhe më shumë se 50% të financimit për 2% të OSHC-ve.

Kuotat e anëtarësisë siguruan deri në 25% të financimit për 18% të OSHC-ve.

Përsa i përket biznesit/aktivitetit të ndërmarrjeve sociale të OSHC-ve, ato dhanë 1-25% të financimit për 15% të OSHC-ve dhe më shumë se 50% të financimit për 3% të OSHC-ve.

Burimi më i vogël i të ardhurave për OSHC-të ishte crowdfunding, që gjeneroi të ardhura për vetëm 1% të OSHC-ve, duke kontribuar 1-25% të buxhetit të tyre.

OS 3.8. OSHC-të kanë burime njerëzore efektive, të fuqizuara dhe të zhvilluara.

Treguesi 3.8.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë staf të punësuar.

Sipas të dhënave të Anketës së OSHC-ve të 2023, 27% e OSHC-ve punuan pa pasur ndonjë staf të paguar. Në total, 37% e OSHC-ve kanë punësuar 1–5 persona, 12% 6–10 persona, dhe 23% 11 ose më shumë persona. Të dhënat flasin për rezultate të ngjashme me 2021.

Treguesi 3.8.b: Pjesa e OSHC-ve që kanë politika organizative të burimeve njerëzore.

2021:

1 – nuk i plotëson standardet	2%
-------------------------------	----

2023:

1 – nuk i plotëson standardet	2%
-------------------------------	----

Sipas Anketës së OSHC-ve, vetëm 2% e OSHC-ve pjesëmarrëse në Anketën e vitit 2023 kishin nëntë politika të burimeve njerëzore, rezultat ky i ngjashëm me atë të 2021.

Pyetjes nëse kishin politika organizative efektive në organizatë, 21% u përgjigjën se kishin një politikë, 11% kishin dy, 9% kishin tre, 5% katër, 7% pesë, 8% gjashtë, 2% shtatë dhe 1% kishte tetë politika.

Nga politikat e burimeve njerëzore të përmendura në Anketë, 38% thanë se kanë Politikë Rekrutimi, 38% kanë Politikë të Diversitetit, Barazisë dhe Përfshirjes, 29% konfirmuan se kanë Politikë të Vlerësimit të Punës, 27% kanë Politikë të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Rriturve Vulnerabël, 26% kanë Politikë të Bullizmit dhe Ngacimit, 21% kanë Politikë Displine, 19% kanë Politikë të Ankesave, 10% kanë Politikë të Pagave, dhe 5% kanë Politikë të Largimit nga Puna. Një numër i konsiderueshëm i OSHC-ve – 27% – thanë se nuk kanë ndonjë nga këto politika në organizatën e tyre.

Treguesi 3.8.c: Pjesa e OSHC-ve që gjatë vitit të kaluar kanë publikuar vendet e lira për staf dhe vullnetarë.

Ky tregues nuk është vlerësuar.

Treguesi 3.8.d: Pjesa e OSHC-ve që kanë politika organizative për rekrutimin e një fuqie punëtore të diversifikuar.

Vlerësimi i vitit 2023 tregon se nuk ka ndryshim që nga vlerësimi i fundit i bërë në 2021.

Specifikisht, lidhur me politikat për inkurajimin e rekrutimit të një fuqi punëtore të diversifikuar, si Politika e Rekrutimit dhe Përfshirjes së Diversitetit, 21% e të anketuarve thanë se kanë politika të tilla në organizatën e tyre.

Treguesi 3.8.e: Pjesa e OSHC-ve ku stafi dhe vullnetarët kanë ndjekur një kurs trajnimi vitin e kaluar.

2021:

4 – plotëson shumicën e standardeve	79%
-------------------------------------	-----

2023:

4 – plotëson shumicën e standardeve	77%
-------------------------------------	-----

Në 2023, një shumicë e konsiderueshme, 77% e OSHC-ve thanë se organizata e tyre ju ka mundësuar stafit dhe vullnetarëve të marrin pjesë në një kurs trajnimi më synim rritjen e kapacitetit të tyre profesional, ndërsa 19% thanë se nuk e kanë bërë këtë. Këto rezultate treguan një rënie të vogël prej 2% krahasuar me rezultatet e vitit 2021.

BIBLIOGRAFIA

1. Raporti Vjetor 2022 për Financimin Publik të OSHC-ve. Linku: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://ojqfinancime.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/07/AnnualReport2022.pdf>
2. COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Kosovo* 2023 Report. Linku: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2023_en
3. Western Balkan 2022 – Monitoring Matrix on Enabling Environment for Civil Society Development Monitoring Matrix on enabling Environment for Civil Society Development, Linku: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.balkancsd.net/novo/wp-content/uploads/2023/04/62-3-MM-Regional-Report-2022.pdf>
4. AML/CFT Regulations and Implications on CSOs in the Western Balkans and Türkiye, linku: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://ecnl.org/sites/default/files/2023-10/112-4-FINAL-Policy-Paper-AMLCFT-Regulations-and-Implications-on-Civil-Society-in-WBT.pdf>
5. Qendra Burimore për Shoqërinë Civile e Kosovës, linku: <https://www.rc-kosovo.org/en/home-english/>
6. Platforma e Konsultimeve Publike, linku: <https://konsultimet.rks-gov.net/index.php>
7. Raporti Vjetor 2022 për Financimin Publik të OSHC-ve, linku: <https://ojqfinancime.rks-gov.net/en/documents-3/>
8. Thirrjet publike për financimin e projekteve të OJF-ve, linku: [Public calls for financing of NGO projects – Public Financial Support for NGOs \(rks-gov.net\)](Public calls for financing of NGO projects – Public Financial Support for NGOs (rks-gov.net))
9. Banka e të dhënave e financimit të OJQ-ve, linku: [Database of financing of NGOs – Public Financial Support for NGOs \(rks-gov.net\)](Database of financing of NGOs – Public Financial Support for NGOs (rks-gov.net))
10. CAF World Giving Index 2023, linku: <https://www.cafonline.org/about-us/research/caf-world-giving-index>
11. Zyra e Kryeministrit, Lista e koncept dokumenteve për 2024, linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/lista-e-koncept-dokumente-ve-2024/>
12. State of Volunteering in Kosovo: Challenges and Perspectives. https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2018/03/D4D_PI_14_ENG_WEB.pdf 8 Nov. 2022.
13. Strategjia Shtetërore e Rinisë 2024–2032, linku: <https://www.mkrs-ks.org/?page=2,44>
14. Zyra për Qeverisje të Mirë, Studim mbi vullnetarizmin në Kosovë 2022, linku: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://zqm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Vullnetarizmi%20n%C3%AB%20Kosov%C3%AB-%20Studimi-2-99-split-merge.pdf>
15. Superpuna, platformë për lehtësimin e aksesit të rinjve në tregun e punës, angazhimin e punonjësve të rinj, linku: <https://superpuna.rks-gov.net/>
16. Raporti Vjetor 2022 i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, linku: <https://trusti.org/en/about-us/reports/annual/>
17. Agjencia e Statistikave e Kosovës 2022, linku: <https://ask.rks-gov.net/>
18. Platforma e Konsultimeve Publike, linku: <https://konsultimet.rks-gov.net>

19. COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Kosovo* 2023 Report, available at: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2023_en
20. Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2019–2023, linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/strategjia-qeveritare-per-bashkepunim-me-shoqerine-civile-2019-2023-16-08-2019/>
21. Këshilli për e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile, linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/the-office-of-prime-minister/council-for-cooperation-of-the-government-ëith-civil-society/>
22. Zyra për Qeverisje të Mirë, Raport Vlerësimi mbi zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile, linku: [RAPORTI I VLERËSIMIT TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË QEVERTARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019–2023 – CiviKos](#)
23. CIVIKOS 2023 RAPORT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË QEVERTISË PËR BASHKËPUNIMIN ME SHOQËRINË CIVILE 2019–2023, linku: [REPORT ON MONITORING THE IMPLEMENTATION OF THE GOVERNMENT STRATEGY FOR COOPERATION ËITH CIVIL SOCIETY 2019–2023 – CiviKos](#)
24. Giving Kosovo 2022: Report on the State of Philanthropy: https://givingbalkans.org/kosovo_en
Highlighting Kosovo’s Top Five Humanitarian Initiatives of 2023: https://givingbalkans.org/kosovo_en/content/kosovos-top-five-humanitarian-initiatives-2023
25. Balkan Public Barometer 2023 Index, linku: <https://www.rcc.int/balkanbarometer/results/2/public>
26. BCSDN Monitoring Matrix Periodical Updates, April 2024, linku: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://balkanbcd.net/novo/wp-content/uploads/2024/04/MM-PERIODICAL-UPDATE-April-2024-Revised-1.pdf>
27. KLGJ Raport Monitorimi i Konsultimeve Publike në Nivel Lokal 2023, linku: <https://www.klgi-ks.com/ëp-content/uploads/2024/04/MONITORING-REPORT-OF-PUBLIC-CONSULTATION-AT-THE-LOCAL-LEVEL-2023-1.pdf>

LISTA E LIGJEVE TË KONSULTUARA

- Udhëzimi Administrativ (Grk) No. 12/2022 Për Regjistrimin, Operimin dhe Çregjistrimin e Organizatave Joqeveritare, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66914>
- Ligji No. 06/L-43 Për Lirinë e Asociimit në OJQ, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>.
- Ligji No. 08/L-166 Për Tubimet Publike, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=70935>
- Ligji No. 08/L-244 Për Amendimin dhe Plotësimin e Ligjit No. 06/L-043 Për Lirinë e Asociimit në OJQ, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85110>
- Ligji Për Procedurat e Përgjithshme Administrative (05/L-031), linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>
- Ligji Për Mosmarrveshjet/Konfliktet Administrative (03/L-202), linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2707> (në fuqi që nga 31.12.2023).
- Kodi No. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, linku: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf>
- Ligji no. 06/L-43 Për Lirinë e Asocimit në OJQ, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>.
- LIGJI NO. 05/L-096 PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12540>
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>
- Ligji No. 05/L-028 Për Tatimin mbi të Ardhurat Personale, Neni 28, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11014>
- LIGJI NO. 03/L-145 PËR FUQIZIMIN DHE PJESËMARRJEN E RINISË. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2654>. Accessed 8 Nov. 2022.
- Rregullat e Procedurës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenet 35 dhe 39, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61266>
- RREGULLORE (GRK) NO. 05/2016 MBI STANDARDET MINIMALE PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15036>